



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 10/2021 PËR CILËSINË E UJIT TË DESTINUAR PËR KONSUM
NJERËZOR¹**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 10/2021 ON THE QUALITY OF WATER INTENDED FOR
HUMAN CONSUMPTION²**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) BR. 10/2021 O KVALITETU VODE NAMENJENJE ZA LJUDSKU
UPOTREBU³**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor, është miratuar në mbledhjen e 47-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 13/47, datë 10.12.2021.

² Administrative Instruction (GRK) no. 10/2021 on the Quality of Water Intended for Human Consumption, was approved on the 47-th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 13/47, dated 10/12/2021.

³ Administrativno Uputstvo (VRK) br. 10/2021 o kvalitetu vode namenjenje za ljudsku upotrebu, usvojen je na 47 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 13/47, datum 10.12.2021.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 7 (7.2) të Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetësinë Publike (GZ, 15.08.2008), nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (GZ, 30.03.2021), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, nenit 19 (6.2) të Rregullores (QKR) Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (GZ, Nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Miratton:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 10/2021 PËR CILËSINË E UJIT TË DESTINUAR PËR KONSUM NJERËZOR</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Ky udhëzim administrativ vendos kuadrin normativ për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njeriut nga efektet negative të</p>	<p>The Government of Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93. (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, in accordance with Article 7 (7.2) of Law no. 02 / L-78 on Public Health (OG, 15.08.2008), Article 4 of Regulation (GRK) No. 02/2021 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (OG, 30.03.2021), amended and supplemented by Regulation (GRK) No. 04/2021, article 19 (6.2) of Regulation (GRK) no. 09/2011 of the Government of the Republic of Kosovo (OG, No.15, 12.09.2011),</p> <p>Approves:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 10/2021 ON THE QUALITY OF WATER INTENDED FOR HUMAN CONSUMPTION</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>1.This Administrative Instruction concerns the quality of water intended for human consumption, in order to protect human health from the adverse effects of any contamination</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93. (4) Ustava Republike Kosova, u skladu sa članom 7 (7.2) Zakona br. 02 / L-78 o javnom zdravstvu (SL, 15.08.2008), člana 4 Pravilnika (VRK) br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Ureda premijera i ministarstava (SL. 30.03.2021.), izmijenjen i dopunjen Uredbom (VRK) br. 04/2021, član 19 (6.2) Pravilnika(VRK) br. 09/2011 o radu Vlade Republike Kosova (SL. br.15, 12.09.2011.),</p> <p>Usvaja:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) BR. 10/2021 O KVALITETU VODE NAMENJENJE ZA LJUDSKU UPOTREBU</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Svrha</p> <p>1.Ovo Administrativno uputstvo uspostavlja normativni kadar o kvalitetu vode namenjene za ljudsku upotrebu, kako bi se zaštitilo ljudsko zdravlje od negativnih efekata nekog</p>
---	--	--

<p>ndonjë ndotjeje të ujit të destinuar për konsum njerëzor duke siguruar që ai të jetë i shëndetshëm dhe i pastër.</p> <p>2. Ky udhëzim administrativ është pjesërisht në përputhje me këto Direktiva të BE-së:</p> <p>2.1 Direktiva 98/83/EC për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor;</p> <p>2.2 Direktiva (KE) 2015/1787 për ndryshimin e Shtojcave II dhe III të Direktivës së Këshillit 98/93/EC mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor;</p> <p>2.3 Direktiva 2013/51/EURATOM që përcakton kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të publikut të përgjithshëm sa i përket substancave radioaktive në ujin e destinuar për konsum njerëzor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p>of water intended for human consumption by ensuring that it is healthy and clean.</p> <p>2.This Administrative Instruction is partially aligned with this EU Directives:</p> <p>2.1 Directive 98/83/EC on the quality of water intended for human consumption;</p> <p>2.2 Directive (EC) 2015/1787 amending Annexes II and III to Council Directive 98/93/EC on the the quality of water intended for human consumption;</p> <p>2.3 Directive 2013/51/EURATOM laying down requirements for the protection of health of the general public with regard to radioactive substances in water intended for human consumption.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p>	<p>zagađenja vode koja je namenjena za ljudsku upotrebu, obezbeđujući da ona bude zdrava i čista.</p> <p>2.Ovim Administrativnim uputstvom je delimično u skladu sa sledećim direktive EU:</p> <p>2.1 Direktiva 98/83/EC o kvalitetu vode namenjene za ljudsku upotrebu;</p> <p>2.2 Direktiva (SE) 2015/1787 o izmeni dodataka II i III Direktive Saveta 98/93/EC o kvalitetu vode namenjene za ljudsku upotrebu;</p> <p>2.3 Direktiva 2013/51/EURATOM koja određuje zahteve za zaštitu opšteg javnog zdravlja što se tiče radioaktivnih supstanci u vodi namenjenoj za ljudsku upotrebu.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Obim</p>
<p>Dispozitat e këtij Udhëzimi administrativ janë të zbatueshme për Institutin kombëtar të shëndetësisë publike, kompanitë publike që furnizojnë ujin e destinuar për konsum njerëzor nga sistemet publike të furnizimit me ujë, subjektet që ambalazhojnë ujin e pijshëm për qëllime të shitjes, si dhe subjektet që</p>	<p>The provisions of this Administrative Instruction are applicable to the National Institute of Public Health, public companies that supply water intended for human consumption from public water supply systems, entities that package drinking water for sales purposes, as well as entities that use</p>	<p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva primenjuju se na Nacionalni Institut za Javno Zdravlje, javna preduzeća koja snabdevaju vodom namenjenu za ljudsku upotrebu iz javnih vodovoda, subjekte koji pakuju vodu za piće za potrebe prodaje, kao i subjekte koji koriste vodu za proizvodnju i promet</p>

<p>përdorin ujin për prodhimin dhe shitjen e produkteve të destinuara për konsum njerëzor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:</p> <p>2. "Uji i destinuar për konsum njerëzor" nënkupton:</p> <p>2.1. të gjitha ujërat në gjendjen e tyre fillestare apo pas trajtimit, që përdoren për pije, gatim, përgatitje të ushqimit ose për qëllime të tjera shtëpiake, pavarësisht origjinës së tyre dhe nëse furnizohen nga ndonjë rrjet i shpërndarjes, shishe ose kontejnerë;</p> <p>2.2. të gjitha ujërat që përdoren në ndonjë ndërmarrje të prodhimit të ushqimit për prodhimin, përpunimin, ruajtjen ose tregtimin e produkteve ose substancave të destinuara për konsum njerëzor përveç nëse autoritetet kompetente janë të bindur që cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në shëndetshmërinë e gjërave ushqimore në formën e tij të fundit.</p> <p>2.3. "Sistemi shtëpiak i shpërndarjes" nënkupton sistemin e tubave, instalimet</p>	<p>water. for the production and sale of products intended for human consumption.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Expressions used in this Administrative Instruction shall have the following meaning:</p> <p>2. "Water intended for human consumption" means:</p> <p>2.1. all the water in its initial state or after the treatment, used for drinking, cooking, food preparation or other domestic purposes, regardless of its origin and if supplied by any distribution network, or bottle or container;</p> <p>2.2. all water used in any food-production undertaking for the manufacture, processing, preservation or marketing of products or substances intended for human consumption unless the competent authorities is satisfied that the quality of the water cannot affect the wholesomeness of the foodstuff in its finished form.</p> <p>2.3 "Domestic distribution system" means the pipework, fittings and</p>	<p>proizvoda namenjenih ljudskoj ishrani.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>2. "Voda namenjena za ljudsku upotrebu" podrazumeva:</p> <p>2.1. sve vode u njihovom početnom stanju ili nakon tretiranja, koje se koriste za piće, kuvanje, pripremanje hrane ili u druge kućne svrhe, nezavisno od njihovog porekla i da li se snabdevaju iz distributivne mreže, flaše ili kontejnera;</p> <p>2.2. sve vode koje se koriste u nekom preduzeću za proizvodnju hrane, za proizvodnju, preradu, čuvanje ili trgovinu proizvoda ili supstanci koje su namenjene za ljudsku upotrebu, osim ako su nadležni organi ubeđeni da kvalitet vode ne može uticati na zdravlje prehrambenih proizvoda u njihovom konačnom obliku.</p> <p>2.3 "Kućni sistem distribucije" podrazumeva sistem cevi, instalacije i</p>
---	---	--

<p>dhe pajisjet që instalohen në mes të rubineteve që zakonisht përdoren për konsum njerëzor dhe rrjetit të shpërndarjes, por vetëm nëse nuk janë përgjegjësi e furnizuesit të ujit;</p> <p>2.4. "Furnizuesi i ujit" nënkupton një subjekt që furnizon të paktën 10 m³ në ditë ose më shumë se 50 persona me ujë të destinuar për konsum njerëzor si një mesatare dhe subjektet që furnizojnë ujin për qëllime publike dhe komerciale të cilat e kanë sistemin e tyre të ujit;</p> <p>2.5. "Monitorimi" përfshin inspektimet, matjet, mostrimet ose analizat, qoftë në mënyrë periodike ose të vazhdueshme;</p> <p>2.6. "Autoriteti shëndetësor" nënkupton Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës - Qendra e Ujit, në pajtim me kërkesat nga nenet 4 dhe 7 të Ligjit për Shëndetësi Publike Nr. 2007/02 L78.</p> <p>2.7. "Derogimi" nënkupton shtyrjen e autorizuar të datës për përputhshmërinë e plotë në një ose më shumë zona të furnizimit, për një kohë të caktuar të kufizuar, për një ose më shumë parametra të specifikuar në lidhje me përputhshmërinë me kufijtë e cilësisë</p>	<p>appliances which are installed between the taps that are normally used for human consumption and the distribution network but only if they are not the responsibility of the water supplier;</p> <p>2.4." Water supplier" means an entity supplying at least 10 m³ a day or more than 50 persons of water intended for human consumption as an average and entities that supply water for public and commercial purposes which have their own water system;</p> <p>2.5. "Monitoring" includes inspections, measurement, sampling or analysis either periodically or continuously;</p> <p>2.6. "Health Authority" means the National Institute of Public Health of Kosovo - Water Center, in accordance with the requirements of articles 4 and 7 of the Public Health Law 2007/02 L78.</p> <p>2.7. "Derogation" means the authorised postponement of the date for full compliance in one or more given supply zones, for a specified limited time, for one or more specified parameters regarding compliance with the chemical quality limits as specified in Annex I Part B of</p>	<p>opremu koja se instalira između slavina koje se uglavnom koriste za ljudsku upotrebu i distributivne mreže, ali samo ukoliko nisu odgovornost snabdevača vodom;</p> <p>2.4. "Snabdevač vodom" podrazumeva subjekat koji snabdeva makar 10 m³ dnevno ili više od 50 lica sa vodom namenjenom za ljudsku upotrebu, kao prosek i subjekte koji snabdevaju vodom u javne i komercijalne svrhe, koje imaju svoj sistem voda;</p> <p>2.5. "Praćenje" obuhvata inspekcije ili analize, bilo periodično ili konstantno;</p> <p>2.6. "Zdravstveni organ" podrazumeva Nacionalni institut za javno zdravlje Kosova – Centar za vodu, u skladu sa zahtevima iz članova 4 i 7 Zakona o javnom zdravstvu, br. 2007/02 L78;</p> <p>2.7. "Derogacija" podrazumeva ovlašćeno pomeranje datuma radi potpune usklađenosti sa jednom ili sa više zona snabdevanja, na određeno ograničeno vreme, za jedan ili više parametara koji su specifikovani u vezi sa usaglašenošću sa granicama hemijskog kvaliteta, kao što je</p>
---	---	---

<p>kimike, siç specifikohet në Pjesën B të Shtojcës I të këtij udhëzimi administrativ. Derogime të tilla mund të bëhen vetëm nga Ministria e Shëndetësisë;</p> <p>2.8. "Planet e sigurisë së ujit" janë planet e hartuara nga furnizuesit e ujit të cilat ndjekin qasjen e planit të sigurisë së ujit të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë lidhur me sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm, duke respektuar parimet e njohura ndërkombëtare mbi të cilat bazohet prodhimi, shpërndarja, monitorimi dhe analiza e parametrave në ujin e pijshëm;</p> <p>2.9. "Substancë radioaktive" nënkupton çdo substancë që përmban një ose më shumë radionuklide, aktiviteti ose përqendrimi i të cilës nuk mund të shpërfilllet sa i përket mbrojtjes nga rrezatimi;</p> <p>2.10. "Doza indikative" ose "DI" nënkupton dozën efektive që pritet të merret për një vit që rezulton nga të gjitha radionuklidet, prania e të cilave është zbuluar në furnizimin me ujë të destinuar për konsum njerëzor, me origjinë natyrore dhe artificiale, por duke përfshirë tritiumin, kaliumin-40, radonin dhe produkte të degraduara jetëshkurtra të</p>	<p>this Administrative Instruction. Such derogations can only be given by Ministry of Health;</p> <p>2.8. "Water Safety Plans" are plans developed by water suppliers which follow the water safety plan approach developed by the World Health Organisation concerning security of drinking water supply, following internationally recognised principles on which the production, distribution, monitoring and analysis of parameters in drinking water is based;</p> <p>2.9. "Radioactive substance" means any substance that contains one or more radionuclides the activity or concentration of which cannot be disregarded as far as radiation protection is concerned;</p> <p>2.10. "Indicative dose" or 'ID' means the committed effective dose for one year of ingestion resulting from all the radionuclides whose presence has been detected in a supply of water intended for human consumption, of natural and artificial origin, but excluding tritium, potassium-40, radon and short-lived radon decay products;</p>	<p>specifikovano u delu B Dodatka I ovog Administrativnog uputstva. Takve derogacije može vršiti samo Ministarstvo zdravstva;</p> <p>2.8. "Planovi za bezbednost vode" su planovi sastavljeni od strane snabdevača vodom koji prate pristup plana za bezbednost vode koji je sastavila Svetska zdravstvena organizacija, u vezi sa bezbednošću snabdevanja pijaćom vodom, poštujući međunarodno poznate principe na kojima se zasniva proizvodnja, distribucija, praćenje i analiza parametara za pijaću vodu;</p> <p>2.9. "Radioaktivna supstanca" podrazumeva svaku supstancu koja sadrži radionuklid, čija se aktivnost ili koncentracija ne može zanemariti u pogledu zaštite od zračenja;</p> <p>2.10. "Indikativna doza" ili "ID" podrazumeva efektivnu dozu za koju se očekuje da će se dobiti tokom jedne godine, a koja rezultira iz svih radionuklida, čije je prisustvo otkriveno u snabdevanju vodom namenjenom za ljudsku upotrebu, prirodnog ili veštačkog porekla, ali izuzimajući tritijum, kalijum-40, radon i degradirane kratkotrajne</p>
---	--	---

<p>radonit;</p> <p>2.11. "Vlera parametrike për substancën radioaktive" nënkupton vlerën e substancave radioaktive në ujën e destinuar për konsum njerëzor mbi të cilën duhet të bëhet vlerësimi nëse prania e substancave radioaktive në ujën e destinuar për konsum njerëzor paraqet rrezik për shëndetin e njeriut, i cili kërkon veprim dhe, kur është e nevojshme, ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për përmirësimin e cilësisë së ujit në nivel që është në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.</p>	<p>2.11. "Parametric value for radioactive substance" means the value of radioactive substances in water intended for human consumption above which it has to be assessed whether the presence of radioactive substances in water intended for human consumption poses a risk to human health which requires action and, where necessary, shall take remedial action to improve the quality of water to a level which complies with the requirements for the protection of human health from a radiation protection point of view.</p>	<p>proizvode radona;</p> <p>2.11. "Parametarska vrednost za radioaktivnu supstancu" podrazumeva vrednost radioaktivnih supstanci u vodi koja je namenjena ljudskoj upotrebi, nad kojima treba da se izvrši procena da li prisustvo radioaktivnih supstanci u vodi namenjenoj za ljudsku upotrebu predstavlja opasnost po zdravlje čoveka, koje zahteva delovanje i, kada je tako nešto neophodno, preduzimanje popravni postupaka radi poboljšanja kvaliteta vode na nivou koji je u skladu sa zahtevima za zaštitu zdravlja čoveka u pogledu zaštite od zračenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Përjashtimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Exemptions</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Izuzeci</p>
<p>1. Ky Udhëzim administrativ nuk vlen për:</p> <p>1.1. Ujërat minerale natyrale dhe ujërat që janë produkte medicinale, të njohura si të tilla nga Autoriteti shëndetësor;</p> <p>1.2. Ujin që përdoret ekskluzivisht për qëllime me të cilat Autoriteti shëndetësor është i kënaqur që cilësia e ujit nuk ka ndikim, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në shëndetin e konsumatorëve;</p> <p>1.3. Ujin e paraparë për konsum njerëzor</p>	<p>1.This Administrative Instruction shall not apply to:</p> <p>1.1. Natural mineral waters and the water that are medicinal products, recognized as such by the Health Authority;</p> <p>1.2. The water that is used exclusively for the purposes for which the Health Authority is satisfied that water quality does not have an impact, whether direct or indirect, to the health of consumers.</p> <p>1.3. Water intended for human consumption</p>	<p>1.Ovo Administrativno uputstvo ne važi za:</p> <p>1.1. Prirodne mineralne vode i vode koje su medicinski proizvodi, poznati kao takvi zdravstvenom organu;</p> <p>1.2. Vodu koja se isključivo koristi u svrhe kojima je zdravstveni organ zadovoljan što kvalitet vode nema direktan ili indirektan uticaj na zdravlje potrošača;</p> <p>1.3. Vodu koja je previđena za ljudsku</p>

<p>nga furnizuesit individualë të cilët mesatarisht ofrojnë më pak se 10 m³ në ditë, ose u shërbejnë më pak se 50 personave, përveç nëse uji është pjesë e veprimtarisë komerciale ose publike.</p> <p>2. Autoriteti shëndetësor duhet të ndërmarrë masa që ta informojë popullatën që furnizohet nga një furnizim i përjashtuar siç është specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, për:</p> <p>2.1. faktin se ky udhëzim administrativ nuk zbatohet ndaj furnizuesve të tillë;</p> <p>2.2. çfarëdo veprimi që mund të ndërmerret në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njerëzve nga efektet negative që rezultojnë nga çfarëdo ndotje e ujit të destinuar për konsum njerëzor;</p> <p>2.3. këshillimin e duhur, ku është identifikuar rreziku i mundshëm ndaj shëndetit të njeriut që rezulton nga cilësia e furnizimit të tillë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Kërkesat e përgjithshme</p> <p>1. Është detyrë e Autoritetit shëndetësor që të ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që uji i destinuar për konsum njerëzor të jetë i</p>	<p>by individual suppliers who provide less than 10 m³ a day as an average, or serving fewer than 50 persons, unless water is supplied as part of commercial or public activity.</p> <p>2. The Health Authority shall take measures to inform the population that it is supplied by an exempt supply as specified under paragraph 1 of this Article, for:</p> <p>2.1. the fact that this Administrative Instruction is not implemented towards such suppliers;</p> <p>2.2. any action that may be taken in order to protect human health from the adverse effects resulting from any contamination of water intended for human consumption;</p> <p>2.3. proper advice, where there is identified potential risk to human health resulting from the quality of such supply.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 General requirements</p> <p>1. It is the duty of the Health Authority to take necessary measures to ensure that water intended for human consumption is healthy</p>	<p>upotrebu od pojedinačnih snabdevača koji u proseku pružaju manje od 10 m³ dnevno, ili služe manje od 50 lica, osim ukoliko je voda deo komercijalne ili javne delatnosti.</p> <p>2. Zdravstveni organ treba da preduzme mere i da obavesti stanovništvo koje se snabdeva iz snabdevanja koje je izuzeto, kao što je specifikovano u stavu 1 ovog člana:</p> <p>2.1. zbog činjenice što se ovo Administrativno uputstvo ne sprovodi na takve snabdevače;</p> <p>2.2. o bilo kakvom postupku koji se može preduzeti kako bi se zaštitilo zdravlje ljudi od negativnih efekata koji su rezultat bilo kog zagađenja vode namenjene za ljudsku upotrebu;</p> <p>2.3. o pravilnom savetovanju tamo gde je identifikovan moguć rizik po zdravlje čoveka, a koji je rezultat kvaliteta takvog snabdevanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Opšti zahtevi</p> <p>1. Dužnost je zdravstvenog organa da preduzme neophodne mere kako bi se obezbedilo da voda koja je namenjena ljudskoj</p>
---	--	---

<p>shëndetshëm dhe i pastër dhe t'i përmbushë kërkesat e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Uji konsiderohet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër nëse:</p> <p>2.1. nuk përmban asnjë mikroorganizëm ose parazit dhe asnjë substancë tjetër që, në numër apo përqendrim, përbën rrezik potencial për shëndetin e njeriut;</p> <p>2.2. i përmbushë kërkesat minimale të parapara në Shtojcën 1, pjesët A dhe B të këtij udhëzimi Administrativ, me përjashtimet e parapara në nenet 13 dhe 16; dhe</p> <p>2.3. iu përmbahet dispozitave përkatëse të nenit 14 paragrafi 1 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>3. Për ujin e futur në shishe ose kontejnerë me qëllim të shitjes, personi juridik që kryen këtë aktivitet duhet të krijojë, ekzekutojë dhe mirëmbajë sisteme dhe procedura të bazuara në parimet e sistemit HACCP, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>4. Çfardo mase që ndërmerret për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, në asnjë rrethanë nuk ka efekt të lejimit, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, qoftë të ndonjë përkeqësimi të</p>	<p>and clean and meets the requirements of this Administrative Instruction;</p> <p>2. Water should be considered to be healthy and clean if:</p> <p>2.1. it does not contain any microorganism and parasite and any other substance that, in number or concentration, constitute a potential danger to human health and;</p> <p>2.2. it meets the minimum requirements set out in Annex 1, parts A and B of this Administrative Instruction, with the exemptions provided in accordance with Articles 13 and 16, and</p> <p>2.3. It complies with the relevant provisions of Article 14 paragraph 1 of this Administrative Instruction.</p> <p>3. For water put into bottles or containers which is intended for sale, the legal person performing this activity shall establish, perform and maintain systems and procedures based on the principles of the HACCP system, in accordance with relevant legislation in force.</p> <p>4. Any measure taken to implement this Administrative Instruction under no circumstances has the effect of allowing, directly or indirectly, any deterioration of the</p>	<p>upotrebi bude zdrava i čista, i da ispunjava zahteve iz ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2. Smatra se da je voda zdrava i čista, ukoliko:</p> <p>2.1. ne sadrži nikakve mikroorganizme ili parazite i nikakvu drugu supstancu, koja po broju ili koncentraciji, predstavlja potencijalan rizik po zdravlje čoveka;</p> <p>2.2. ispunjava minimalne zahteve predviđene Dodatkom 1, delovima A i B ovog Administrativnog uputstva, uz izuzetke predviđene članovima 13 i 16; i</p> <p>2.3. se pridržava dotičnih odredbi iz člana 14, stava 1 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>3. Za vodu koja se ubacuje u flaše ili kontejnere u svrhu prodaje, pravno lice koje vrši ovu aktivnost, treba da stvori, sprovodi i održava sisteme i procedure na osnovu principa HACCP sistema, u skladu sa relevantnim zakona.</p> <p>4. Bilo koja mera koja se preduzima radi sprovođenja ovog Administrativnog uputstva, ni u kojoj okolnosti nema efekat direktnog ili indirektnog dozvoljavanja, bilo nekog</p>
--	---	--

<p>cilësisë së tanishme të ujit që përdoret për konsum nga njeriu nëse ajo është relevante për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, apo ndonjë ngritje të ndotjes së ujërave që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Pika e përputhshmërisë</p> <p>1. Vlerat parametrike të parapara në Shtojcën 1 duhet të respektohen:</p> <p>1.1 në rastin e ujit që furnizohet nga një rrjet shpërndarës, në pikën brenda pronës, në të cilën uji del nga rubinetat që zakonisht përdoren për konsum nga njeriu;</p> <p>1.2 në rastin e ujit që furnizohet nga një cisternë, në pikën në të cilën uji del nga cisterna;</p> <p>1.3 në rastin e ujit që vendoset në shishe ose kontejnerë të destinuar për shitje, në pikën në të cilën uji vendoset në shishe ose kontejnerë;</p> <p>1.4 në rastin e ujit që përdoret në një ndërmarrje të prodhimit të ushqimit, në pikën ku uji përdoret në ndërmarrje.</p> <p>2. Në rastin e mbuluar me nënparagrafin 1.1 të këtij neni, furnizuesi i ujit konsiderohet se ka</p>	<p>present quality of water intended for human consumption, if it is relevant to health protection, or any increase in pollution of waters used for the production of drinking water.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Point of compliance</p> <p>1. Parametric values set out in Annex 1, shall comply with:</p> <p>1.1 in the case of water supplied from a distribution network, at the point within premises, at which it emerges from the taps that are normally used for human consumption;</p> <p>1.2 in the case of water supplied from a tanker, at the point at which water emerges from the tanker;</p> <p>1.3 in the case of water put into bottles or containers intended for sale, at the point at which the water is put into the bottles or containers;</p> <p>1.4 in the case of water used in a food-production undertaking, at the point where the water is used in the undertaking.</p> <p>2. In the case covered by subparagraph 1.1 of this Article, the water supplier is deemed to</p>	<p>pogoršanja trenutnog kvaliteta vode koja se koristi ljudsku upotrebu ukoliko je ona relevantna za zaštitu ljudskog zdravlja, ili neko povećanje zagađenja voda koje se koriste za proizvodnju pijaće vode.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Tačka usaglašenosti</p> <p>1. Parametarske vrednosti predviđene Dodatkom 1 moraju se poštovati:</p> <p>1.1 u slučaju vode koja se snabdeva iz distributivne mreže, u tački unutar imanja, u kojoj voda izlazi iz slavine, koja se obično koristi ljudsku upotrebu;</p> <p>1.2 u slučaju vode koja se snabdeva iz cisterne u tačku u kojoj voda izlazi iz cisterne;</p> <p>1.3 u slučaju vode koja se stavlja u flaše i kontejnere koji su namenjeni prodaji, u tački u kojoj se voda stavlja u flaše i kontejnere;</p> <p>1.4 u slučaju vode koja se koriste u preduzeću za proizvodnju hrane, u tački u kojoj se koristi u preduzeću.</p> <p>2. U slučaju pokrivenim podstavim 1.1 ovog člana, snabdevač vodom smatra se da je</p>
--	--	---

<p>përbushur detyrimet e tij sipas këtij udhëzimi administrativ, ku mund të konstatohet se mospërputhja me vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1, Pjesa A dhe B e këtij udhëzimi administrativ, është për shkak të sistemit shtëpiak të shpërndarjes. Megjithatë, në ndërtesat dhe vendet ku uji iu ofrohet qytetarëve, siç janë shkollat, spitalet dhe restorantet, pronari dhe menaxheri i ndërtesës ose strukturës duhet të sigurojë që përputhshmëria në pikën e furnizimit me vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1 Pjesa A dhe B, është ruajtur edhe në pikën ku uji del nga rubineti.</p>	<p>have fulfilled its obligations under this Administrative Instruction, where it can be concluded that non-compliance with the parametric values set out in Annex 1 Part A and B of this Administrative Instruction is due to the domestic distribution system. However, in buildings and premises where water is provided to citizens, such as, schools, hospitals and restaurants, the owner and manager of the building or structure shall ensure that compliance, in the point of supply, with parametric values set in Annex 1 part A and B, is maintained also at the point where water comes from the tap.</p>	<p>ispunio svoje obaveze u skladu sa ovim Administrativnim uputstvom, gde se može konstatovati da neusaglašenost sa parametarskim vrednostima koje su određene Dodatkom 1, delovima A i B ovog Administrativnog uputstva, jeste zbog kućnog sistema distribucije. Međutim, u zgradama i mestima gde se voda pruža građanima, kao što su škole, bolnice i restorani, vlasnik i menadžer zgrade ili strukture treba da obezbedi da je usklađenost u tački snabdevanja sa parametarskim vrednostima određenim u Dodatku 1, delovima A i B, očuvana i u tački gde voda izlazi iz slavine.</p>
<p>3. Në rastet kur zbatohet paragrafi 2 i këtij neni dhe ekziston rreziku që uji nga nënparagrafi 1.1 të mos përputhet me vlerat parametrike në rubinet, duhet të merren masat në vijim:</p>	<p>3. In cases where paragraph 2 of this Article applies and there is risk that the water from subparagraph 1.1 does not comply with parametric values in the tap, the following measures shall be taken:</p>	<p>3. U slučajevima kada se sprovodi stav 2 ovog člana i postoji rizik da voda iz podstave 1.1 nije u skladu sa parametarskim vrednostima u slavini, treba da se preduzmu sledeće mere:</p>
<p>3.1 Autoriteti shëndetësor kërkon nga furnizuesi i ujit të ndërmerrë masat e duhura për të ulur ose eliminuar rrezikun e mospërputhjes me vlerat parametrike, të cilat mund të përfshijnë këshilla për pronarët e pronave për çdo veprim të mundshëm korrigjues që mund të ndërmarrin, dhe/ose masa të tjera, siç janë teknikat e trajtimit të duhur për të ndryshuar natyrën ose karakteristikat e ujit</p>	<p>3.1 the Health Authority shall require the water supplier to take appropriate measures to reduce or eliminate the risk of non-compliance with the parametric values, which may include advice to property owners about any possible corrective action they can undertake, and/or other measures, such as proper handling techniques to change the nature or characteristics of the water before it is</p>	<p>3.1 Zdravstveni organ traži od snabdevača vodom da preduzme potrebne mere kako bi se smanjio ili eliminisao rizik od neusaglašenosti sa parametarskim vrednostima, koje mogu da obuhvate mere vlasnicima imovine o svakom mogućem popravnom postupku koji mogu da preduzmu i/ili ostale mere, kao što su tehnike pravilnog tretiranja kako bi se izmenile priroda ili karakteristike vode pre</p>

<p>para se të furnizohet në mënyrë që të ulet ose eliminohet rreziku nga uji i cili nuk përputhet me vlerat parametrike pas furnizimit;</p> <p>3.2 Autoriteti shëndetësor dhe furnizuesi i ujit, në kuadër të juridiksionit të tyre përkatës, duhet të sigurojnë që konsumatorët e tyre të jenë të informuar dhe të këshilluar siç duhet rreth ndonjë veprimi të mundshëm shtesë për korrigjimet që ata duhet të ndërmarrin.</p>	<p>supplied in order to reduce or eliminate the risk of water which does not comply with the parametric values after supply;</p> <p>3.2. the Health Authority and the water supplier within their respective jurisdiction, shall ensure that their customers are informed and properly advised about any possible remedial action they should undertake.</p>	<p>nego što se snabde, kako bi se smanjio ili eliminisao rizik od vode koja nije usklađena sa parametarskim vrednostima nakon snabdevanja;</p> <p>3.2 Zdravstveni organ i snabdevač vodom, u okviru njihove dotične nadležnosti, treba da obezbede da njihovi potrošači budu obavješteni i da pravično dobiju savete o nekom mogućem dodatnom postupku radi poboljšanja koje oni treba da preduzmu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Monitorimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Monitoring</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Praćenje</p>
<p>1. Monitorimi i rregullt operacional dhe monitorimi i përputhshmërisë së cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor bëhet sipas neneve 8 dhe 9 të këtij udhëzimi administrativ, përkatësisht, për të verifikuar që uji në dispozicion për konsum njerëzor i plotëson kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, dhe në veçanti vlerat parametrike të specifikuara në Shtojcën 1, sa i përket përputhshmërisë së specifikuar në paragrafin 1 të nenit 6.</p> <p>2. Monitorimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të bëhet:</p> <p>2.1. në pikat e nxjerrjes së ujërave</p>	<p>1. Regular operational monitoring and compliance monitoring of the quality of water intended for human consumption is carried out under Articles 8 and 9 of this Administrative Instruction, respectively, to verify that the water available for human consumption meets the requirements of this Administrative Instruction, and in particular the parametric values specified in Annex 1, in terms of compliance specified in paragraph 1 of Article 6.</p> <p>2. The monitoring identified under paragraph 1 of this Article shall be carried out:</p> <p>2.1. at the abstraction points of the surface</p>	<p>1. Redovno operativno praćenje i praćenje usklađenosti kvaliteta vode namenjene za ljudsku upotrebu vrši se u skladu sa članovima 8 i 9 ovog Administrativnog uputstva, odnosno radi verifikacije da voda koja je na raspolaganju za ljudsku upotrebu ispunjava zahteve ovog Administrativnog uputstva, a posebno parametarske vrednosti specifikovane u Dodatku 1, što se tiče usklađenosti koja je specifikovana stavom 1 u članu 6.</p> <p>2. Praćenje određeno u stavu 1 ovog člana treba vršiti:</p> <p>2.1. na tačkama ekstrakcije površinskih</p>

<p>sipërfaqësore dhe në burimet nëntokësore;</p> <p>2.2. në çfarëdo pike brenda sistemit të furnizimit të ujit, përfshirë burimin e ujit, infrastrukturën e bartjes, fabrikat e trajtimit, rezervuarët e ruajtjes dhe sistemet e shpërndarjes;</p> <p>2.3. në pikën ku uji futet në shishe ose kontejner;</p> <p>2.4. në pikën ku uji përdoret për prodhimin e ushqimit;</p> <p>2.5. në rastin e ujit të furnizuar nga cisternat, brenda cisternave dhe rubinetit që përdoren për këtë qëllim.</p> <p>3. Sa i përket monitorimit sipas nënparagrafit 2.1 të këtij neni, duhet të shfrytëzohen rezultatet e çdo programi të monitorimit të kryer në Kosovë nga autoritetet përgjegjëse për monitorimin e trupave ujorë.</p> <p>4. Në rast se uji i destinuar për konsum njerëzor furnizohet nga cisterna lëvizëse, monitorimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të zgjerohet për përshtatshmërinë higjienike të cisternave.</p> <p>5. Kur dezinfektimi është pjesë e përgatitjes ose shpërndarjes së ujit të destinuar për konsum njerëzor, monitorimi nga paragrafi 1 i</p>	<p>waters and groundwater sources;</p> <p>2.2. at any point within the water supply system, including water source, transmission infrastructure, treatment plants, storage reservoir and distribution systems;</p> <p>2.3. at the point where the water is put into the bottle or container;</p> <p>2.4. at the point where the water is used for food manufacturing.</p> <p>2.5. in the case of water supplied by tanks, inside the tanks and the tap as a used for this purpose</p> <p>3.Regarding the monitoring under sub-paragraph 2.1 of this Article, the results of any monitoring programme established in Kosovo by responsible authorities for monitoring of water bodies, shall be used.</p> <p>4.In case that water intended for human consumption is supplied from movable tanks, the monitoring from paragraph 1 of this article shall be expanded to the hygienic eligibility of tanks.</p> <p>5.When disinfection is part of the preparation or distribution of water intended for human consumption, monitoring from paragraph 1 of</p>	<p>voda i na izvorima podzemnih voda;</p> <p>2.2. na bilo kojoj tački unutar sistema snabdevanja vodom, obuhvatajući i izvor vode, infrastrukturu prenosa, fabrike za prečišćavanje, rezervoare za čuvanje i sisteme distribucije;</p> <p>2.3. u tački gde se voda puni u flaše i kontejnere;</p> <p>2.4. u tački gde se voda koristi za proizvodnju hrane;</p> <p>2.5. u slučaju vode koja je snabdevena iz cisterni, unutar cisterni i slavina koje se koriste u tu svrhu.</p> <p>3. Što se tiče praćenja u skladu podstavom 2.1 ovog člana, treba iskoristiti rezultate svakog programa praćenja koje je izvršeno na Kosovu od strane organa odgovornih za praćenje vodenih tela.</p> <p>4.U slučaju da se snabdevanje vode namenjene za ljudsku upotrebu vrši iz pokretne cisterne, praćenje iz stava 1 ovog člana treba da se proširi i na higijensku usklađenost cisterni.</p> <p>5.Kada je dezinfekcija deo pripreme ili distribucije vode koja je namenjena za ljudsku upotrebu, praćenje iz stava 1 ovog člana treba</p>
--	---	---

<p>këtij neni duhet ta verifikojë efektivitetin e trajtimit të dezinfektimit të aplikuar dhe që çdo kontaminim nga produktet e dezinfektimit të mbahet sa më i ulët që të jetë e mundur pa rrezikuar dezinfektimin.</p> <p>6. Monitorimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë në përputhje me specifikimet e analizës së parametrave të caktuar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>7. Çdo laborator ku analizohen mostrat, duhet të ketë një sistem të kontrollit të cilësisë analitike, në përputhje me Shtojcën 3 të këtij udhëzimi administrativ, që i nënshtrohet verifikimit nga një organ i autorizuar i cili është jashtë kontrollit të laboratorit dhe që është i miratuar nga Autoriteti shëndetësor për atë qëllim.</p> <p>8. Vlerësimi i shëndetshmërisë së ujit për konsum njerëzor është përgjegjësi e Autoritetit shëndetësor.</p> <p>9. Inspektimi sanitar i ujit, fabrikave të trajtimit të ujit, pajisjeve dhe stabilimenteve të trajtimit të ujërave është përgjegjësi e Inspektoratit Sanitar në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>this Article shall verify the effectiveness of the disinfection treatment applied and that any contamination from disinfection products is kept as low as possible without compromising the disinfection.</p> <p>6. Monitoring in accordance with paragraph 1 of this Article shall be in accordance with the specifications of certain parameter analysis in Annex 2 of this Administrative Instruction.</p> <p>7. Any laboratory where samples are analyzed, shall have a system of analytical quality control, in conformity with Annex 3 of this Administrative Instruction, that is subject to verification by an authorised body outside the control of the laboratory and that is approved by the Health Authority for that purpose.</p> <p>8. Evaluation of the wholesomeness of water for human consumption is the responsibility of the Health Authority.</p> <p>9. Sanitary inspection of water, water treatment plants, water treatment equipments and facilities shall be the responsibility of Sanitary Inspectorate in accordance with applicable legislation.</p>	<p>da verifikuje efektivnost tretiranja dezinfekcije koja je primenjena i da se svaka kontaminacija dezinfekcionim sredstvima održava što je moguće niže, bez dovođenja dezinfekcije u opasnost.</p> <p>6. Praćenje u skladu sa stavom 1 ovog člana treba da bude u skladu sa specifičnostima analize parametara koji su određeni u Dodatku 2 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>7. Svaka laboratorija u kojoj se analiziraju uzorci, mora da ima sistem kontrole analitičkog kvaliteta, u skladu sa Dodatkom 3 ovog Administrativnog uputstva, koji podleže verifikaciji ovlašćenog organa van kontrole laboratorije i koji je usvojen od strane zdravstvenog organa u tu svrhu.</p> <p>8. Ocena zdravlja vode za ljudsku upotrebu je odgovornost zdravstvenog organa.</p> <p>9. Sanitarna inspekcija vode, fabrika za preradu vode, opreme i postrojenja za prečišćavanje vode je odgovornost Sanitarne inspekcije, u skladu sa zakonodavstvom na snazi.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 8 Monitorimi operacional</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Operational Monitoring</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Operativno praćenje</p>
<p>1. Monitorimi operacional duhet të bëhet nga furnizuesi i ujit për të verifikuar cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor brenda tërë sistemit të ujit.</p> <p>2. Për monitorimin nga paragrafi 1 i këtij neni, pikat e mostrimit dhe frekuenca duhet të dakordohen me Autoritetin shëndetësor.</p> <p>3. Për monitorimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, furnizuesi i ujit mund të përdorë laboratorë të brendshëm ose të nënkontraktuar, me kusht që këta laboratorë të përmbushin kushtet e paragrafit 7 të nenit 7.</p> <p>4. Rezultatet e monitorimit siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni duhet të ruhen për një periudhë prej së paku pesë (5) viteve për konsultim nga administratat që kryejnë kontrollet e jashtme.</p> <p>5. Furnizuesit e ujit duhet të hartojnë dhe mirëmbajnë Planet e monitorimit operacional për secilën prej zonave të tyre të furnizimit, të cilat azhurnohen çdo tri (3) vjet dhe miratohen zyrtarisht nga Autoriteti shëndetësor.</p>	<p>1.Operational monitoring is required to be carried out by the water supplier to verify the quality of water intended for human consumption within the entire water system.</p> <p>2. For monitoring under paragraph 1 of this Article, the sampling points and frequency shall be agreed with the Health Authority.</p> <p>3.For the monitoring as set out in the paragraph 1 of this Article, the water supplier may use internal or subcontracted laboratories, provided that such laboratories meet the terms of paragraph 7 of Article 7 of this Administrative Instruction.</p> <p>4.The results of monitoring as set out in paragraph 1 of this Article should be kept for a period of at least five years for consultation by the administrations that perform external audits.</p> <p>5.Water suppliers shall develop and maintain Operational Monitoring Plans for each of their supply zones which shall be updated every 3 years and shall be formally approved by the Health Authority.</p>	<p>1.Operativno praćenje treba da izvrši snabdevač vodom kako bi utvrdio kvalitet vode koja je namenjena za ljudsku upotrebu, i čitavom vodenom sistemu.</p> <p>2.Za praćenje iz stava 1 ovog člana, tačke uzrokovanja i učestalost moraju se dogovoriti sa zdravstvenim organom.</p> <p>3. Za praćenje određeno stavom 1 ovog člana, snabdevač vodom može da koristi unutrašnje ili podugovorene laboratorije, pod uslovom da te laboratorije ispunjavaju uslove iz stava 7, člana 7.</p> <p>4. Rezultati praćenja kako je određeno stavom 1 ovog člana moraju se čuvati u periodu od najmanje pet (5) godina radu konsultacije od strane administracija koje vrše spoljnu kontrolu.</p> <p>5.Snabdevači vodom treba da sastave i održavaju planove operativnog praćenja za svaku od njihovih zona snabdevanja, koji se ažuriraju svake tri (3) godine i koje zvanično usvaja zdravstveni organ.</p>

<p>6. Sa herë që planifikohet punë për mirëmbajtjen rutine të rrjetit të ujit nga furnizuesi i ujit e cila mund të ndikojë në cilësinë e ujit të pijshëm, furnizuesi i ujit duhet ta informojë me shkrim Autoritetin shëndetësor pesë (5) ditë para fillimit të punës së planifikuar të mirëmbajtjes.</p> <p>7. Kur zhvillohen punë të riparimit urgjent nga furnizuesi i ujit, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ujit të pijshëm, Autoriteti shëndetësor duhet të informohet me shkrim brenda njëzet e katër (24) orëve nga fillimi i punëve emergjente.</p> <p>8. Çdo furnizues i ujit duhet të publikojë deri në mesin e vitit pasues një raport të hollësishëm vjetor që mbulon secilën prej zonave të tij të furnizimit të ujit, mbi cilësinë e ujit të pijshëm duke përfshirë detaje për të gjitha mospërputhjet e rëndësishme të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e konsumatorëve.</p> <p>9. Kur mospërputhja nga paragrafi 8 i këtij neni është për një parametër mikrobiologjik në Shtojcën 1 Pjesa A, veçanërisht <i>E-coli</i>, furnizuesi i ujit duhet të paraqes një përshkrim të hollësishëm të rrethanave të mospërputhjes dhe masave specifike praktike ose të lidhura me menaxhimin për të parandaluar që kjo të ndodh sërish.</p>	<p>6. Whenever routine maintenance work on the water network is planned by the water supplier which could affect the quality of the drinking water, the water supplier shall inform the Health Authority five (5) days in advance of the planned maintenance work in writing.</p> <p>7. Where emergency repair work is carried out by the water supplier, which could affect the quality of the drinking water, the Health Authority shall be informed in writing within twentyfour (24) hours of the emergency work commencing.</p> <p>8. Each water supplier shall publish a detailed annual report covering each of its water supply zones, by the middle of the following year, on the quality of drinking water including details of all significant non-compliances, which could affect the health of consumers.</p> <p>9. Where the non-compliance referred to in the paragraph 8 of this Article was for a microbiological parameter in Annex 1 Part A especially <i>E-coli</i>, the water supplier shall provide a detailed account of the background to the non-compliance and specific practical or management-related measures to prevent it from re-occurring.</p>	<p>6. Kada god se planira rad na rutinskom održavanju vodne mreže od strane snabdevača vodom, koji može da utiče na kvalitet pijaće vode, snabdevač vodom mora pismeno da obavesti zdravstveni organ pet (5) dana pre početka planiranih radova na održavanju.</p> <p>7. Kada se odvijaju poslovi hitne popravke od strane snabdevača vodom, koji mogu da utiču na kvalitet pijaće vode, zdravstveni organ treba da bude pismeno obavешten u roku od dvadeset i četiri (24) časova od početka hitnih radova.</p> <p>8. Svaki snabdevač vodom treba da do polovine naredne godine objavi detaljan godišnji izveštaj koji pokriva svaku od njegovih zona snabdevanja vodom, o kvalitetu pijaće vode, obuhvatajući detalje o svim bitnim neusklađenostima koje mogu uticati na zdravlje potrošača.</p> <p>9. Kada neusklađenost iz stava 8 ovog člana je u vezi sa jednim mikrobiološkim parametrom u Dodatku 1, delu A, posebno <i>E-coli</i>, snabdevač vodom treba da podnese detaljan opis okolnosti neusklađenosti i specifičnih praktičnih mera ili mera u vezi sa upravljanjem kako bi sprečio da se to ponovo dogodi.</p>
--	---	--

<p>10. Të gjitha mostrat që kanë të bëjnë me cilësinë e ujit të pijshëm dhe të dhënat analitike nga sistemi i ujit të monitoruara nga furnizuesi i ujit në pajtim me Planin e miratuar të monitorimit operacional duhet të arkivohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të vihen në dispozicion për kontroll nga organet e miratuara qeveritare, përfshirë Autoritetin shëndetësor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Monitorimi i përputhshmërisë</p> <p>1. Monitorimi i përputhshmërisë përbëhet nga të gjitha masat që ndërmerren nga Autoriteti shëndetësor për të verifikuar se uji në dispozicion të konsumatorëve i përmbush kushtet e këtij udhëzimi administrativ, dhe në veçanti vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1 në pikën e përputhshmërisë të specifikuar në nenin 6 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Monitorimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni bazohet në një program monitorimi të përpiluar nga Autoriteti shëndetësor.</p> <p>3. Programi nga paragrafi 2 i këtij neni duhet t'i përmbushë kushtet e parapara në Shtojcën 2</p>	<p>10.All drinking water quality-related sampling and analytical data from the water system monitored by the water supplier in accordance with the approved Operational Monitoring Plan shall be archived fully in line with the requirements of the applicable legislation and shall be made available for audit by approved Government bodies including the Health Authority.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Compliance Monitoring</p> <p>1.Compliance monitoring consists of all measures taken by the Health Authority to verify that the water available to consumers meets the requirements of this Administrative Instruction, and in particular the parametric values set in Annex 1, in the point of compliance as specified in Article 6 of this Administrative Instruction.</p> <p>2. The monitoring as set out under paragraph 1 of this Article is based on a monitoring programme established by the Health Authority.</p> <p>3. The programme must meet the requirements set forth under Annex 2 and shall include</p>	<p>10.Svi uzorci koji imaju veze sa kvalitetom pijaće vode i sa analitičkim podacima iz vodenog sistema koje je pratio snabdevač vodom u skladu sa usvojenim planom operativnog praćenja treba da se arhiviraju u skladu sa zahtevima zakonodavstva na snazi i da se stave na raspolaganje kontroli od strane odobrenih vladinih organa, obuhvatajući i zdravstveni organ,</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Praćenje usklađenosti</p> <p>1.Praćenje usklađenosti sastoji se od svih mera koje preuzima zdravstveni organ kako bi verifikovao da je voda koja na raspolaganju potrošačima ispunjava sve uslove iz ovog Administrativnog uputstva i posebno parametarske vrednosti koje su određene u Dodatku 1 u tački usklađenosti koja je specifikovana članom 6 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2.Praćenje određeno u stavu 1 ovog člana zasnovano je na programu praćenja koji je sastavio zdravstveni organ.</p> <p>3.Program iz stava 2 ovog člana mora da ispuni uslove koji su predviđeni u Dodatku2 i</p>
---	---	---

<p>dhe duhet të përfshijë përcaktimin e pikave për marrjen e mostrave për testim dhe frekuencën e mostrimit, për të siguruar që mostrat të përfaqësojnë cilësinë e ujit të konsumuar përgjatë tërë vitit.</p> <p>4. Autoriteti shëndetësor duhet të sigurojë që monitorimi shtesë kryhet prej rastit në rast për substancat dhe mikroorganizmat, për të cilat nuk është përcaktuar ndonjë vlerë parametrike në Shtojcën 1 nëse ka arsye për të dyshuar se ata mund të jenë të pranishëm në sasi që përbën rrezik potencial për njerëzit, në mënyrë që të përmbushen kushtet e paragrafit 2.1 të nenit 5.</p> <p>5. Për monitorimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, autoriteti shëndetësor përdor laboratorët e vet ose të nënkontraktuar me kusht që ata të plotësojnë kushtet e parapara në paragrafin 7 të nenit 7.</p> <p>6. Monitorimi i parametrave radioaktivë në pajtim me Shtojcën 4 dhe Shtojcën 5 të këtij udhëzimi administrativ është përgjegjësi e Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore ose e organizatës pasardhëse përgjegjëse për mbrojtje nga rrezatimi.</p> <p>7. Për monitorimin nga paragrafi 6 i këtij neni,</p>	<p>determination of sampling points of the samples for testing and sampling frequency to ensure that samples represent the quality of the water consumed throughout the year.</p> <p>4.The Health Authority shall ensure that additional monitoring is carried out case by case for substances and microorganisms, for which no parametric value is set in Annex 1, if there is a reason to suspect that they may be present in amounts that constitute potential hazard for humans, in order to meet the requirements of paragraph 2.1 of Article 5.</p> <p>5.For the monitoring as set out under paragraph 1 of this Article, the Health Authority shall use its own or subcontracted laboratories provided that they meet the requirements set forth in the paragraph 7 of Article 7.</p> <p>6. Monitoring of radioactive parameters in accordance with Annex 4 and Annex 5 of this Administrative Instruction is the responsibility of the Agency for Radiation Protection and Nuclear Safety or the successor organisation in charge with protection from radiation.</p> <p>7.For monitoring under paragraph 6 of this</p>	<p>treba da obuhvati određivanje tačaka za uzimanje uzoraka za testiranje i frekventnost uzimanja uzoraka, kako bi se obezbedilo da uzorci predstavljaju kvalitet vode koja je upotrebljavana tokom čitave godine.</p> <p>4.Zdravstveni organ treba da obezbedi da se dodatno praćenje vrši od slučaja do slučaja na supstance i mikroorganizme, za koje nije određena neka parametarska vrednost u Aneksu 1, ukoliko postoje razlozi za sumnju da oni mogu biti prisutni u količinama koje predstavljaju potencijalnu opasnost za ljude, kako bi se ispunili uslovi iz stava 2.1, člana 5.</p> <p>5.Za praćenje koje je predviđeno stavom 1 ovog člana, zdravstveni organ treba da koristi svoje ili podugovorene laboratorije pod uslovom da one ispunjavaju uslove predviđene stavom 7 člana 7.</p> <p>6.Praćenje radioaktivnih parametara u skladu sa Dodatkom 4 i Dodatkom 5 ovog Administrativnog uputstva je odgovornost Agencije za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost ili organizacije naslednice, odgovorne za zaštitu od zračenja.</p> <p>7.Za praćenje iz stava 6 ovog člana, tačke i</p>
---	---	---

<p>pikat dhe frekuenca e mostrimit përcaktohen pas konsultimit me Autoritetin shëndetësor.</p> <p>8. Rezultatet e monitorimit nga paragrafi 6 i këtij neni i raportohen Autoritetit shëndetësor në baza vjetore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Substancat dhe materialet në kontakt me ujin e destinuar për konsum njerëzor</p> <p>1. Asnjë substancë ose material që përdoret për instalimet e reja që përdoren për përgatitjen apo shpërndarjen e ujit të destinuar për konsum njerëzor ose papastërtitë që ndërlidhen me këto substanca ose materiale për instalime të reja nuk duhet të qëndrojnë në ujin e destinuar për konsum njerëzor në përqendrime më të larta se sa është e nevojshme për përdorimin e tyre të synuar dhe nuk duhet të zvogëlojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve të paraparë me këtë udhëzim administrativ.</p> <p>2. Kushtet teknike të nevojshme për përputhshmëri me paragrafin 1 të këtij neni miratohen nga Ministri i Shëndetësisë, pas konsultimit me ministritë përkatëse përgjegjëse për tregti dhe mbrojtje të mjedisit.</p>	<p>Article, sampling points and frequency shall be performed upon consultation with the Health Authority.</p> <p>8. Results of the monitoring under paragraph 6 of this Article shall be reported to the Health Authority on annual basis.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Substances and materials in contact with water intended for human consumption</p> <p>1. No substance or material used for new installations used for the preparation or distribution of water intended for human consumption or impurities associated with these substances or materials for new installations should remain in water intended for human consumption in concentrations higher than is necessary for their intended use and must not reduce, either directly or indirectly, human health protection envisaged by this Administrative Instruction.</p> <p>2. Technical requirements necessary for compliance with the paragraph 1 of this Article shall be issued by the Minister of Health, upon consultation with the respective ministries in charge for trade and environmental protection.</p>	<p>frekventnost uzimanja uzoraka određuju se nakon konsultovanja sa zdravstvenim organom.</p> <p>8. Rezultati praćenja iz stava 6 ovog člana izveštavaju se zdravstvenom organu na godišnjem osnovu.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Supstance i materijali u kontaktu sa vodom koja je namenjena za ljudsku upotrebu</p> <p>1. Nijedna supstanca ili materijal koji se koristi za nove instalacije koje se koriste za pripremanje ili distribuciju vode koja je namenjena za ljudsku upotrebu ili nečistoće koje su povezane sa ovim supstancama ili materijalima za nove instalacije, ne treba da ostaju u vodi koja je namenjena za ljudsku upotrebu u koncentracijama višim od potrebnih za njihovu predviđenu upotrebu i ne treba da smanji, direktno ili indirektno, zaštitu zdravlja ljudi koja je predviđena ovim Administrativnim uputstvom.</p> <p>2. Tehničke uslove koji su neophodni za usklađenosti sa odredbama stava 1 ovog usvaja ministar zdravlja, nakon konsultacija sa dotičnim ministarstvom koje je odgovorno za trgovinu i zaštitu životne sredine.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 11 Procedurat për rastet e mospërputhjes me vlerat parametrike</p>	<p align="center">Article 11 Procedures for cases of non-compliance with parametric values</p>	<p align="center">Član 11 Postupci u slučajevima nesaglasnosti sa parametarskim vrednostima</p>
<p>1. Duke pasur parasysh përjashtimet e parapara në nenet 13 dhe 16 të këtij udhëzimi administrativ, ku uji i destinuar për konsum njerëzor nuk i përmbush vlerat parametrike të specifikuara në Shtojcën 1, Autoriteti shëndetësor duhet:</p> <p>1.1 T'i njoftojë autoritetet përkatëse dhe furnizuesin e ujit për mospërputhjen e ujit me vlerat parametrike;</p> <p>1.2 Të vendosë dhe t'iu rekomandojë furnizuesve të ujit dhe autoriteteve përkatëse veprime korigjuese, përfshirë kufizimet e mundshme të përdorimit të ujit që nevojiten për të mbrojtur shëndetin e njeriut.</p> <p>1.3 Veprimet korigjuese nga nënparagrafi 1.2 i këtij neni vendosen bazuar në nivelin e mospërputhjes, rëndësinë e vlerës parametrike dhe rrezikun e mundshëm ndaj shëndetit të njeriut, duke pasur parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut që do të mund të shkakttoheshin nga ndonjë ndërprerje e furnizimit të ujit ose nga ndonjë kufizim i furnizimit.</p>	<p>1. Taking into account the exemptions set forth in Articles 13 and 16 of this Administrative Instruction, where water intended for human consumption does not meet the parametric values specified in Annex 1, the Health Authority shall:</p> <p>1.1 Notify the relevant authorities and the water supplier about the non-compliance of water with parametric values;</p> <p>1.2 Determine and recommend to the water supplier and relevant authorities corrective actions, including possible restrictions on water use, that are needed to protect human health.</p> <p>1.3 Corrective actions under sub-paragraph 1.2 of this Article shall be decided based on the level of non-compliance, the relevance of the parametric value, and potential risk to human health, taking into account the risk to human health that could be caused by the interruption of water supply or from any reduction of supply.</p>	<p>1. Imajući u vidu izuzetke predviđene članovima 13 i 16 ovog Administrativnog uputstva, gde voda namenjena za ljudsku upotrebu ne ispunjava parametarske vrednosti specifikovane u Dodatku 1, zdravstveni organ treba:</p> <p>1.1 Da obavesti dotične organe i snabdevača vodom o neusaglašenosti vode sa parametarskim vrednostima;</p> <p>1.2 Da uspostavi i da preporuči snabdevačima vodom i dotičnim organima popravne postupke, obuhvatajući i moguća ograničenja korišćenja vode, koja su potrebna radi zaštite zdravlja čoveka.</p> <p>1.3 Popravni postupci iz podstava 1.2 ovog člana uspostavljaju se na osnovu nivoa neusklađenosti, bitnosti parametarske vrednosti i mogućeg rizika po zdravlje čoveka, imajući u vidu rizike po zdravlje čoveka koji bi mogli da budu izazvani prekidom snabdevanja vodom ili ograničavanjem snabdevanja.</p>

<p>2. Furnizuesi i ujit, sipas këshillave të Autoritetit shëndetësor, menjëherë duhet të kryejë hetime për të identifikuar shkakun e mospërputhjes dhe për të zbatuar masat e duhura menaxheriale për të rikthyer cilësinë e ujit sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe për t'i ofruar autoritetit shëndetësor brenda njëzet e tetë (28) ditëve nga momenti kur ndodh rasti i mospërputhjes me parametrat e Shtojcës 1 Pjesa A dhe Pjesa B, një përmbledhje me shkrim të konkluzioneve të hetimit, përfshirë arsyet kryesore të mospërputhjes, ndikimin tek konsumatorët dhe masat që furnizuesi i ujit ka ndërmend të ndërmarrë, përfshirë ndonjë investim kapital të propozuar dhe/ose veprime menaxheriale për të ulur rrezikun që diçka e ngjashme të ndodh në të ardhmen.</p> <p>3. Procedurat e parapara në paragrafin 1 dhe paragrafin 2 të këtij neni të zbatohen në të njëjtën mënyrë kur substancat apo agjentët biologjikë, për të cilët nuk është caktuar ndonjë vlerë parametrike në Shtojcën 1, gjenden në ujë në sasi që mund të shkaktojnë ndonjë rrezik potencial për shëndetin e njeriut.</p> <p>4. Autoriteti shëndetësor, furnizuesi i ujit dhe autoritetet përkatëse, secili në kuadër të juridiksionit të vet përkatës, duhet të sigurojnë që konsumatorët të jenë të informuar dhe të këshilluar siç duhet rreth ndonjë veprimi të mundshëm shtesë korrigjues që ata duhet të</p>	<p>2.The water supplier, according to the advice of the Health Authority shall immediately conduct an investigation to identify the cause of the non-compliance, and to implement appropriate management measures to restore water quality as soon as possible, and to provide to the Health Authority within twentyeight (28) days of the occurrence in the case of any non-compliance with Annex 1 Part A and Part B parameters, a written summary of the conclusions of the investigation including the main reasons for the non-compliance, the impact on consumers and the measures that the water supplier intends to take including any capital investments proposed and/or management actions to reduce the risk of a similar occurrence in the future.</p> <p>3. Procedures described in the paragraph 1 and paragraph 2 of this Article shall apply in the same way when substances or biological agents, for which there is not set any parametric value in Annex 1, are found in water in quantities that may cause any potential risk to human health.</p> <p>4.The Health Authority, the water supplier, and the relevant authorities, each within their respective jurisdiction, shall ensure that consumers are informed and properly advised about any possible additional corrective action they should take.</p>	<p>2.Snabdevaç vodom, u skladu sa savetima zdravstvenog organa, odmah treba da izvrši istrage kako bi identifikovao uzrok neusklađenosti i kako bi sproveo potrebne menadžerske mere radi povratka kvaliteta vode što je brže moguće, kao i kako bi zdravstvenom organu u roku od dvadeset i osam (28) dana od trenutka kada se dogodio slučaj neusklađenosti sa parametrima iz Dodatka 1, deo A i deo B, pružao pisani sažetak zaključaka istrage, obuhvatajući i glavne razloge neusaglašenosti, uticaj na potrošače i mere koje snabdevaç vodom ima nameru da preduzme, obuhvatajući i neku kapitalnu investiciju koja je predložena i/ili menadžerske postupke kako bi se smanjio rizik da se nešto slično dogodi ubuduće.</p> <p>3.Postupci predviđeni stavom 1 i stavom 2 ovog člana sprovode se na isti način kada se supstance ili biološki agensi, o kojima nije određena neka parametarska vrednost u Dodatku 1, nalaze u vodi u količinama koje mogu izazvati potencijalnu opasnost po zdravlje čoveka.</p> <p>4.Zdravstveni organ, snabdevaç vodom i dotični organi, svaki u okviru svoje dotične jurisdikcije, treba da obezbede da potrošači budu obavesteni i savetovani kako treba o nekom mogućem dodatnom popravnom postupku koji treba da preduzmu.</p>
--	---	--

<p>ndërmarrin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Komisioni profesional për ujin e destinuar për konsum njerëzor</p> <p>1. Qeveria e themelon Komisionin për Ujin e Destinuar për Konsum Njerëzor (më tutje në tekst: Komisioni) me mandat pesë (5) vjeçar si një organ profesional dhe këshillues që propozon masa dhe udhëzime me qëllim të sigurimit të shëndetshmërisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor në Kosovë.</p> <p>2. Komisioni përbëhet nga nëntë (9) anëtarë si në vijim:</p> <p>2.1.Një përfaqësues të Autoritetit shëndetësor i cili do të jetë kryetar i Komisionit;</p> <p>2.2.Një përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra;</p> <p>2.3.Një përfaqësues të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit;</p> <p>2.4.Një përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për menaxhimin e resurseve ujore;</p> <p>2.5.Një përfaqësues të Agjencisë Kosovare</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Expert Commission for Water Intended for Human Consumption</p> <p>1.The Government shall establish the Expert Commission for water Intended for Human Consumption (hereof: the Commission) for the term of five (5) years as a professional and advisory body that proposes measures and guidelines for the purpose of ensuring wholesomeness of water intended for human consumption in Kosova.</p> <p>2. The Commission consists of nine (9) members as follows:</p> <p>2.1.One representative of the Health Authority that shall act as the Chairman of the Commission;</p> <p>2.2One representative of the Secretariat of the Inter-Ministerial Water Council;</p> <p>2.3.One representative of the Water Services Regulation Authority;</p> <p>2.4.One representative of the Ministry responsible for water resources management;</p> <p>2.5.One representative of the Kosova</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Stručna komisija za vodu koja je namenjena ljudskoj upotrebi</p> <p>1.Vlada osniva Komisiju za vodu koja je namenjena ljudskoj upotrebi (u daljem tekstu samo Komisija), na mandat od pet (5) godina, kao stručan i savetodavan organ koji predlaže mere i uputstva u cilju obezbeđivanja zdrave vode koja je namenjena ljudskoj upotrebi na Kosovu.</p> <p>2. Komisija se sastoji od devet (9) članova i to:</p> <p>2.1.Jednog predstavnika zdravstvenog organa koji će biti predsednik Komisije;</p> <p>2.2.Jednog predstavnika Sekretarijata Međuministarskog saveta za vode;</p> <p>2.3.Jednog predstavnika Regulatornog organa za vodne usluge</p> <p>2.4.jednog predstavnika ministarstva odgovornog za upravljanje vodnim resursima;</p> <p>2.5.Jednog predstavnika iz Kosovske</p>
---	--	---

<p>për Standardizim;</p> <p>2.6.Një përfaqësues të Inspektoratit Sanitar;</p> <p>2.7.Një përfaqësues të Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;</p> <p>2.8.Një përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për ekonomi.</p> <p>2.9.Një përfaqësues të shoqatës së kompanive që ofrojnë shërbime publike të ujit.</p> <p>3. Komisioni harton udhëzime, rekomandime dhe opinione të ekspertëve mbi çështjet në vijim që janë përgjegjësi e autoritetit shëndetësor:</p> <p>3.1 Përshtatja me kushtet e përcaktuara në Shtojcat 1, 2 dhe 3 për progresin shkencor dhe teknik ose zbatimin e dispozitave të miratuara në nivel evropian;</p> <p>3.2 Përcaktimi i vlerave për parametrat shtesë që nuk përfshihen në Shtojcën 1 kur është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut në disa pjesë të vendit ose në të gjithë vendin; vlerat e specifikuar së paku duhet të plotësojnë</p>	<p>Standardisation Agency;</p> <p>2.6.One representative of the Sanitary Inspectorate;</p> <p>2.7.One representative of the Agency for Protection from Radiation and Nuclear Safety;</p> <p>2.8.One representative of the Ministry responsible for economic ;</p> <p>2.9.One representative of the association of companies that provide public water services.</p> <p>3.The Commission shall develop guidelines, recommendations and expert opinion on following issues which are the responsibility of the Health Authority:</p> <p>3.1 Adaptation to the conditions set forth in Annexes 1, 2 and 3 to scientific and technical progress or the implementation of the provisions adopted at European level;</p> <p>3.2 Determination of values for additional parameters not included in Annex 1 when it is necessary to protect human health in some parts of the country or across the country; the values specified must at least meet the conditions set forth in paragraph</p>	<p>agencije za standardizaciju;</p> <p>2.6.Jednog predstavnika Sanitarne inspekcije;</p> <p>2.7.Jednog predstavnika Agencije za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost;</p> <p>2.8.Jednog predstavnika iz ministarstva odgovornog za privredu;</p> <p>2.9.Jednog predstavnika Udruženja kompanije koje pružaju javne vodne usluge.</p> <p>3.Komisija sastavlja uputstva, preporuke i mišljenja stručnjaka o pitanjima koja su dole navedena, a koja su odgovornost zdravstvenog organa:</p> <p>3.1 Usklađivanje sa uslovima određenim u Dodacima 1, 2 i 3 o naučnom i tehničkom napretku ili sprovođenju odredbi usvojenih na evropskom nivou;</p> <p>3.2 Određivanje vrednosti o dodatnim parametrima koji nisu obuhvaćeni Dodatkom 1 kada je neophodno zaštititi zdravlje čoveka u nekim delovima zemlje ili čitavoj zemlji; vrednosti koje su specifikovane, moraju makar ispuniti</p>
--	--	---

<p>kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 5;</p> <p>3.3 Zhvillimi i metodave referuese të analizës që do të përdoren për parametrat e specifikuar në Shtojcën 3, Pjesa 2, në përputhje me termat e përcaktuara aty;</p> <p>3.4. Sigurimi i metodave të mundshme përveç atyre të specifikuara në Shtojcën 3, Pjesa 1, nëse do të mund të demonstrohet se rezultatet e fituara janë të paktën po aq të besueshme sa ato të prodhuara me metodat e specifikuara;</p> <p>3.5 Identifikimi i ujit që përdoret në biznesin ushqimor ku cilësia nuk mund të ndikojë në shëndetshmërinë e produktit final, në përputhje me dispozitat përkatëse të paragrafit 1.2 të nenit 2 të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>3.6 Hartimi i standardeve teknike për trajtimin dhe dezinfektimin e ujit, në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 7 të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>3.7 Hartimi i standardeve teknike për instalimin e sistemeve të furnizimit me ujë;</p> <p>3.8 Hartimi i standardeve teknike për</p>	<p>2 of Article 5 of this Administrative Instruction;</p> <p>3.3 Development of reference methods of analysis to be used for the parameters specified in Annex 3 Part 2, in accordance with the terms set forth there;</p> <p>3.4. Provision of possible methods other than those specified in Annex 3, Part 1, provided that it can be demonstrated that the results obtained are at least as reliable as those produced by the methods specified;</p> <p>3.5 Identification of water used in the food business where quality can not influence the final product wholesomeness of food, in accordance with relevant provisions of paragraph 1.2 of Article 2 of this Administrative Instruction;</p> <p>3.6 Development of technical guidelines for water treatment and disinfection, in accordance with relevant provisions of Article 7 of this Administrative Instruction;</p> <p>3.7 Development of technical guidelines for installation of water supply systems;</p> <p>3.8 Development of technical guidelines</p>	<p>uslove određene u stavu 2, člana 5;</p> <p>3.3 Razvoj referentnih metoda analize koje će se koristiti za parametre specifikovane u Dodatku 3, delu 2, u skladu sa terminima koji su tamo određeni;</p> <p>3.4. Obezbeđivanje mogućih metoda, pored onih specifikovanih u Dodatku 3, delu 1, ukoliko može da se demonstrira da su dobijeni rezultati makar onoliko pouzdani, koliko oni koji su generisani specifikovanim metodama;</p> <p>3.5 Identifikacija vode koja se koristi u prehrambenoj industriji, gde kvalitet ne može uticati na zdravlje konačnog proizvoda, u skladu sa dotičnim odredbama stava 1.2, člana 2 ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>3.6 Sastavljanje tehničkih standarda za tretiranje i dezinfekciju vode, u skladu sa dotičnim odredbama iz člana 7 ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>3.7 Sastavljanje tehničkih standarda za instaliranje sistema snabdevanja vodom;</p> <p>3.8 Sastavljanje tehničkih standarda za</p>
---	---	---

<p>gërmimin, shpimin, mirëmbajtjen, mbylljen dhe rihapjen e puseve;</p> <p>3.9 Hartimi i standardeve teknike për mostrimin e ujit për konsum njerëzor dhe kushtet laboratorike ku testohen mostrat, gjithashtu në ndërlidhje me specifikimet e përcaktuara në Shtojcën 3;</p> <p>3.10 Zhvillimi i procedurave për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në rastet kur uji i destinuar për konsum njerëzor nuk i plotëson vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1, në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 6 dhe nenit 11 të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>3.11 Vendimet e marra në rastet e mospërputhjes me vlerat parametrike ose specifikimet e përcaktuara në Shtojcën 1, Pjesa C, të përmendura në nenin 14 të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>3.12 Menaxhimi i informacioneve dhe raportimi;</p> <p>3.13 Zhvillimi i standardeve teknike për përdorimin e pajisjeve dhe aparateve që synojnë përmirësimin e karakteristikave të ujit të destinuar për konsum njerëzor të shpërndarë nëpër shtëpi dhe ndërtesa</p>	<p>for digging, drilling, maintenance, closure and reopening of wells;</p> <p>3.9 Development of technical guidelines for sampling water for human consumption and laboratory conditions where the samples are tested, also in connection with the specifications set forth in Annex 3;</p> <p>3.10 Development of procedures for assessing and managing risks in cases where water intended for human consumption does not meet the parametric values specified in Annex 1, in accordance with relevant provisions of Article 6 and Article 11 of this Administrative Instruction;</p> <p>3.11 Decisions taken in the cases of non-compliance with the parametric values or specifications set out in Annex 1, Part C, referred to in Article 14 of this Administrative Instruction;</p> <p>3.12 Management of information and reporting;</p> <p>3.13 Development of technical standards for the use of equipment and devices aimed at improving the characteristics of water intended for human consumption distributed in the household and public</p>	<p>kopanje, bušenje, održavanje, zakopavanje i ponovno otvaranje bunara;</p> <p>3.9 Sastavljanje tehničkih standarda o uzimanju uzoraka vode za ljudsku upotrebu i o laboratorijskim uslovima u kojima se testiraju uzorci, kao i povezivanje sa specifikacijama određenim u Dodatku 3;</p> <p>3.10 Razvoj procedura o oceni i upravljanju rizicima u slučajevima kada voda koja je namenjena za ljudsku upotrebu ne ispunjava parametarske vrednosti određene u Dodatku 1, u skladu sa dotičnim odredbama člana 6 i člana 11 ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>3.11 Odluke koje su donete u slučajevima neusaglašenosti sa parametarskim vrednostima ili specifikacijama određenim u Dodatku 1, delu C, a koje su pomenute u članu 14 ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>3.12 Upravljanje informacijama i izveštavanje;</p> <p>3.13 Razvoj tehničkih standarda o korišćenju opreme i aparata koji teže poboljšanju karakteristika vode koja je namenjena ljudskoj upotrebi koja se distribuira po kućama i javnim zgradama;</p>
--	---	---

<p>publike;</p> <p>3.14 Hartimi i udhëzimeve teknike lidhur me transportin e ujit të destinuar për konsum njerëzor;</p> <p>3.15 Miratimi i përjashtimeve të përkohshme nga vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1, pjesa B, ose të rregulluara në nënparagrafin 3.2 të paragrafit 3 të këtij neni të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>3.16 Hartimi i Udhëzimeve kombëtare për Planet e Sigurisë së Ujit;</p> <p>3.17 Shqyrtimi dhe aprovimi i Planeve të Sigurisë së Ujit të përgatitura nga furnizuesit e ujit</p> <p>3.18 Përmbajtja e raportit që duhet t'i paraqitet Komisionit Evropian në përputhje me paragrafin 5 të nenit 17 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Derogimet</p> <p>1. Niveli i derogimit nga vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1, Pjesa B, ose i përcaktuar në përputhje me nënparagrafin 3.2 të paragrafit 3 të nenit 12 të këtij udhëzimi administrativ, mund të ngrihet në një vlerë</p>	<p>buildings;</p> <p>3.14 Development of technical guidelines regarding the transport of water intended for human consumption;</p> <p>3.15 Approving temporary exemptions from parametric values set in Annex 1, part B, or regulated under sub-paragraph 3.2 of paragraph 3 of this Article;</p> <p>3.16 Development of National Guidelines for Water Safety Plans;</p> <p>3.17 Reviewing and approving Water Safety Plans prepared by the Water Suppliers;</p> <p>3.18 The content of the report to be submitted to the European Commission in accordance with paragraph 5 of Article 17 of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Derogations</p> <p>1. The level of derogation from the parametric values set in Annex 1, Part B, or determined in accordance with sub-paragraph 3.2 of paragraph 3 of Article 12 can be raised up to a maximum value determined by a decision by</p>	<p>3.14 Sastavljanje tehničkih uputstava u vezi sa prevozom vode koja je namenjena ljudskoj upotrebi;</p> <p>3.15 Usvajanje privremenih izuzetaka od parametarskih vrednosti koje su određene u Dodatku 1, delu B ili koje su regulisane u podstavu 3.2, stava 3, ovog člana u ovom Administrativnom uputstvu.</p> <p>3.16 Sastavljanje Nacionalnih uputstava o planovima bezbednosti vode;</p> <p>3.17 Razmatranje i prihvatanje Planove bezbednosti vode koje su pripremili snabdevači vodom;</p> <p>3.18 Sadržaj izveštaja koji treba da se podnese Evropskoj komisiji, u skladu sa stavom 5, člana 17 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Derogacije</p> <p>1. Nivo derogacije od parametarskih vrednosti određenih u Dodatku 1, delu B, ili određenih u skladu sa podstavom 3.2, stava 3 člana 12 ovog Administrativnog uputstva, može da se podigne na maksimalnu vrednost koja se</p>
---	--	--

<p>maksimale të përcaktuar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, me kusht që derogimi të mos paraqesë rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut dhe me kusht që uji i furnizuar për konsum njerëzor në zonën përkatëse nuk mund të garantohet në asnjë mënyrë tjetër të arsyeshme.</p> <p>2. Derogimet nga paragrafi 1 kufizohen në një periudhë sa më të shkurtër që është e mundur dhe nuk duhet të tejkalojnë tri (3) vite.</p> <p>3. Gjashtë (6) muaj para afatit të skadimit të derogimit, duhet të bëhet një vlerësim nën koordinimin e autoritetit shëndetësor që të vlerësohet se a është arritur progres i mjaftueshëm.</p> <p>4. Bazuar në shqyrtimin në paragrafin 2 të këtij neni, me vendim të Ministrit të Shëndetësisë mund të lejohet derogimi i dytë me kohëzgjatje maksimale prej tri (3) vitesh.</p> <p>5. Gjashtë (6) muaj para skadimit të periudhës së derogimit të dytë, duhet të bëhet një vlerësim nën koordinimin e autoritetit shëndetësor që të vlerësohet se a është arritur progres i mjaftueshëm.</p> <p>6. Çfarëdo derogimi i lejuar në përputhje me paragrafët 1 ose 4 të këtij neni duhet të specifikojë si më poshtë:</p>	<p>the Minister of Health, provided that the derogation does not present potential hazard to human health and provided that the water supplied for human consumption in the area concerned can not be guaranteed in any other reasonable way.</p> <p>2. Derogations under paragraph 1 shall be limited to a period as short as possible and should not exceed three (3) years.</p> <p>3. Six (6) months before the expiration of the derogation there should be made an assessment under the coordination of the Health Authority to assess whether sufficient progress has been achieved.</p> <p>4. Based on the review under paragraph 2, the second derogation of a maximum duration of three (3) years may be allowed by decision of the Minister of Health.</p> <p>5. Six (6) months before the expiration of the period of the second derogation, an assessment should be done under the coordination of the Health Authority to assess whether sufficient progress has been achieved.</p> <p>6. Any derogation granted in accordance with paragraphs 1 or 4 must specify the following:</p>	<p>određuje odlukom ministra zdravlja, uz uslov da derogacija ne predstavlja moguću opasnost po zdravlje čoveka i uz uslov da voda kojom se snabdeva određena zona za ljudsku upotrebu ne može da se garantuje ni na koji drugi razuman način.</p> <p>2. Derogacije iz stava 1 ograničavaju se na što kraći mogućí period i ne treba da prevaziđu tri (3) godine.</p> <p>3. Šest (6) meseci pre roka isteka derogacije, treba izvršiti ocenu pod koordinacijom zdravstvenog organa kako bi se ocenilo da li postignut dovoljan napredak.</p> <p>4. Na osnovu razmatranja u stavu 2 ovog člana, odlukom ministra zdravlja može se dozvoliti druga derogacija u maksimalnom trajanju od tri (3) godine.</p> <p>5. Šest (6) meseci pre isteka drugog perioda odstupanja, izvršiće se procena pod koordinacijom zdravstvenog organa kako bi se procenilo da li je postignut dovoljan napredak.</p> <p>6. Svaka dozvoljena derogacija u skladu sa stavovima od 1 do 4 ovog člana, mora da specifikuje sledeće:</p>
---	--	---

<p>6.1 Bazën (arsyetimin) për derogim;</p> <p>6.2 Parametrat që do t'i nënshtrohen derogimit të propozuar me rezultatet përkatëse të monitorimit paraprak dhe vlerën maksimale të lejueshme nën derogim për çdo parametër përkatës;</p> <p>6.3 Zonën gjeografike, sasinë e ujit të furnizuar çdo ditë, popullatën e prekur dhe se a ka ndonjë ndikim negativ apo jo në ndonjë ndërmarrje të prodhimit të ushqimit;</p> <p>6.4 Një plan të detajuar të monitorimit, me një frekuencë më të madhe të monitorimit nëse është e nevojshme;</p> <p>6.5 Një përmbledhje të planit për veprimet e nevojshme korrigjuese, përfshirë planin e punës, vlerësimin e kostos, programin e financimit dhe dispozitat për shqyrtim;</p> <p>6.6 Kohëzgjatja e nevojshme e derogimit.</p> <p>7. Nëse autoriteti shëndetësor konsideron se mospërputhja me vlerat parametrike është e parëndësishme dhe nëse veprimet e ndërmarra janë në përputhje me nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ dhe kjo është e mjaftueshme që të evitohet problemi brenda tridhjetë (30) ditëve, nuk ka nevojë të</p>	<p>6.1 Grounds (justification) for derogation;</p> <p>6.2 Parameters to be subject to the proposed derogation with, the relevant results of previous monitoring and maximum permissible value under the derogation for each relevant parameter;</p> <p>6.3 The geographical area, the amount of water supplied each day, the population affected and whether there is any adverse impact or not in any food production enterprise;</p> <p>6.4 A detailed monitoring plan, at an increased frequency of monitoring if necessary;</p> <p>6.5 A summary of the plan for corrective action needed, including the work plan, cost estimation, financial programme and review provisions;</p> <p>6.6 The necessary derogation duration.</p> <p>7.If the Health Authority considers that non-compliance with the parametric values is trivial, and if actions taken are in accordance with Article 11 of this Administrative Instruction, it is sufficient to avoid the problem within 30 days, the requirements of paragraph 1 to 5 need not be applied.</p>	<p>6.1 Osnov (obrazloženje) za derogaciju;</p> <p>6.2 Parametre koji će podleći predloženoj derogaciji sa dotičnim rezultatima prethodnog praćenja i maksimalnu dozvoljenu vrednost pod derogacijom za svaki dotični parametar;</p> <p>6.3 Geografsku zonu, količinu vode kojom se vrši snabdevanje svakog dana, pogođeno stanovništvo i da li postoji ili ne postoji neko preduzeće za proizvodnju hrane;</p> <p>6.4 Detaljan plan praćenja, uz veliku frekvenciju praćenja ukoliko je potrebno;</p> <p>6.5 Sažetak plana neophodnog popravnog delovanja, obuhvatajući i plan rada, procenu troškova, program finansiranja i odredbe za razmatranje;</p> <p>6.6. Neophodno trajanje derogacije.</p> <p>7.Ukoliko zdravstveni organ smatra da je neusaglašenost sa parametarskim vrednostima konstantna i ukoliko su preduzeti postupci u skladu sa članom 11 ovog Administrativnog uputstva i to je dovoljno da se izbegne problem u roku od trideset (30) dana, nema</p>
--	--	--

<p>aplikohen kërkesat e paragrafit 1 deri 5 të këtij neni.</p> <p>8. Mbështetja mund të mos jepet sipas paragrafit 7 të këtij neni, në rast se dështimi për të përmbushur cilëndo vlerë parametrike nga ana e furnizuesit të ujit në fjalë ka ndodh në më shumë se tridhjetë (30) ditë të mbledhura brenda dymbëdhjetë (12) muajve të kaluar.</p> <p>9. Autoriteti shëndetësor, autoritetet relevante dhe furnizuesi i ujit, brenda juridiksionit të tyre përkatës, duhet të sigurojnë që popullsia e prekur nga çfarëdo derogimi i tillë të informohet menjëherë në mënyrë të duhur për këtë derogim dhe për kushtet në bazë të së cilave aprovohet ky derogim.</p> <p>10. Ku është e nevojshme, duhet t'u jepen këshilla grupeve të caktuara të popullsisë për të cilat derogimi mund të paraqesë rrezik të veçantë.</p> <p>11. Ky nen nuk aplikohet për ujin e destinuar për konsum njerëzor i vendosur në shishe ose kontejnerë që është i destinuar për shitje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Mospërputhja me parametrat e indikatorëve</p>	<p>8.Support may not be granted under paragraph 7 of this Article, in case of failure to meet any parametric value by water suppliers in question occurred in more than thirty (30) days collected within the past twelve (12) months.</p> <p>9.The Health Authority, relevant authorities and the the water supplier, each within their respective jurisdiction, shall ensure that the population affected by any such derogation is promptly informed in an appropriate manner for the derogation and the conditions under which this derogation is governed.</p> <p>10.Where necessary, advice should be given to particular population groups for which the derogation could present a particular risk.</p> <p>11.This article shall not be applicable to water intended for human consumption put in bottles or containers which is intended for sale.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Non-compliance with the indicator parameters</p>	<p>potrebe da se primenjuju zahtevi od stava 1 do stava 5 ovog člana.</p> <p>8.Podrška u skladu sa stavkom 7 može da se ne pruži u slučaju neuspelosti ispunjenja bilo koje od parametarskih vrednosti od strane snabdevača vodom o kojem je reč a koja traje više od trideset (30) dana, u toku proteklih dvanaest (12) meseci.</p> <p>9.Zdravstveni organ, relevantni organi i snabdevač vodom, u njihovoj dotičnoj jurisdikciji, moraju da obezbede da stanovništvo koje je pogođeno bilo kakvom takvom derogacijom odmah bude informisano pravilno o toj derogaciji ili o uslovima na osnovu kojih se dozvoljava ta derogacija.</p> <p>10.Gde je potrebno, treba davati savete dotičnim grupama stanovništva ta koje derogacije može predstavljati poseban rizik.</p> <p>11.Ovaj član se ne primenjuje na vodu koja je namenjena ljudskoj upotrebi napunjenoj u flaše ili kontejnere, a koja je namenjena prodaji.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Neusaglašenost sa parametrima indikatora</p>
---	--	--

<p>Në rast të mospërputhjes me vlerat parametrike apo me specifikacionet e përcaktuara në Shtojcën 1, furnizuesi i ujit, në bazë të këshillave të dhëna nga Autoriteti shëndetësor lidhur me rrezikun e mundshëm ndaj shëndetit të njeriut që rezulton nga mospërputhshmëria me parametrat specifike, duhet të ndërmerre veprime përmirësuese për të rikthyer cilësinë e ujit kur kjo është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut.</p>	<p>In case of non-compliance with the parametric values or with the specifications set out in Annex 1, the water supplier, according to advice given by Health Authority regarding the potential risk to human health resulting from non-compliance with specific parameters, shall take remedial action to restore water quality where that is necessary to protect human health.</p>	<p>U slučaju neusaglašenosti sa parametarskim vrednostima ili sa specifikacijama određenim u Dodatku 1, snabdevač vodom, na osnovu saveta koje mu je dao zdravstveni organ u vezi sa mogućim rizikom po ljudsko zdravlje, koji je rezultat neusaglašenosti sa specifičnim parametrima, mora de preduzme postupke poboljšanja, kako bi povratio kvalitet vode kada je to potrebno da se zaštiti zdravlje čoveka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Mbikëqyrja</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Supervision</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Nadzor</p>
<p>1.Mbikëqyrjen inspektuese e kryen Inspektorati Sanitar në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>2. Ministria e Shëndetësisë përmes Autoritetit shëndetësor kryen mbikëqyrjen administrative të zbatimit të dispozitave të këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p>1. Inspective supervision shall be done by the Sanitary Inspectorate in accordance with its authorities and responsibilities given with according with relevant legislation in force.</p> <p>2. Ministry of Health through the Health Authority conducts the administrative supervision of the implementation of provisions of this Administrative Instruction.</p>	<p>1. Inspekcijski nadzor vrši Sanitarna inspekcija u skladu sa nadležnostima i odgovornostima koja ime prema relevantnom zakonu na snazi.</p> <p>2. Ministarstvo zdravstva preko zdravstvenog organa vrši administrativni nadzor sprovođenja odredbi ovog Administrativnog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Dispozitat kalimtare</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Transitory provisions</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Prelazne odredbe</p>
<p>1. Komisioni profesional themelohet me vendim të Qeverisë brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p>1. The Commission for Water Intended for Human Consumption shall be established by the Government decision within twelve (12) months from entry into force of this Administrative Instruction.</p>	<p>1. Stručna komisija se osniva odlukom Vlade u roku od dvanaest (12) meseci od stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva.</p>

<p>2. Miratimi i metodave të specifikuara të analizës nga laboratorët e miratuar, siç përcaktohet në Shtojcën 3 Pjesa A për parametrat mikrobiologjikë duhet të jetë plotësisht në përputhje me metodat e rishikuara deri më 31.12.2022.</p> <p>3. Miratimi i karakteristikave të rishikuara të performancës për kimikatet dhe parametrat e indikatorëve në laboratorët e miratuar, siç përcaktohet në Shtojcën 3 Pjesa B, duhet të jetë plotësisht në përputhje me karakteristikat e rishikuara të performancës deri më 31.12.2022</p> <p>4. Udhëzimet kombëtare për Planet e Sigurisë së Ujit, në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 Pjesa C, Seksioni 6 (vii), duhet të hartohen nga Komisioni profesional dhe të nxirren nga Autoriteti shëndetësor përmes Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike brenda njëzetekatër (24) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>5. Dorëzimi i Planeve të Sigurisë së Ujit për secilën zonë të furnizimit të ujit nga furnizuesit e ujit duhet të kryhet deri më 31.12.2025</p> <p>6. Miratimi i të gjitha Planeve të Sigurisë së Ujit nga Autoriteti shëndetësor me rekomandimet e Komisionit profesional në</p>	<p>2. Adoption of the specified methods of analysis by approved laboratories as set out in Annex 3 Part A for micorbiological parameters shall be fully in accordance with the revised methods by 31.12.2022.</p> <p>3. Adoption of the revised performance characteristics for chemical and indicator parameters in approved laboratories as set out in Annex 3 Part B shall be fully in accordance with the revised performance characteristics by 31.12.2022.</p> <p>4. National Guidelines on Water Safety Plans in accordance with the requirements of Annex 2 Part C section 6(vii) shall be developed by the Commission and issued by the Health Authority through the National Institute of Public Health within twentyfour (24) months of entry into force of this Adminstrative Instruction</p> <p>5. Submission of Water Safety Plans for each water supply zone by water suppliers shall be completed by 31.12.2025</p> <p>6. Approval of all Water Safety Plans by the Health Authority on recommendations of the Commission in accordance with the</p>	<p>2. Usvajaje specifikovanih metoda analize o strane odobrenih laboratorija, kako je određeno u Dodatku 3 delu A o mikrobiološkim parametrima, moraju u potpunosti biti u skladu sa metodama koje su razmotrene do 31.12.2022. godine.</p> <p>3. Usvajanje razmotrenih karakteristika performansi za hemikalije i parametre indikatora u odobrenim laboratorijama, kako je određeno Dodatkom III, deo B, mora da bude u potpunom skladu sa razmotrenim karakteristikama performanse, do 31.12.2022 godine.</p> <p>4. Nacionalna uputstva o planovima bezbednosti vode, u skladu sa zahtevima iz Dodatka 2 deo C, sekcija 6 (vii), treba da sastavi Stručna komisija i da donese zdravstveni organ, preko Nacionalnog instituta za javno zdravlje u roku od dvadeset i četiri (24) meseca, od dana stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>5. Predaja Planova bezbednosti vode za svaku zonu snabdevanja vodom od strane snabdevača vodom, mora se završiti do 31.12.2025. godine.</p> <p>6. Usvajanje svih planova bezbednosti vode od strane zdravstvenog organa uz preporuke Stručno komisije, u skladu sa zahtevima iz Dodatka 2, deo C, sekcija 6 (vii) mora da se</p>
--	--	--

<p>përputhje me kërkesat e Shtojcën 2, Pjesa C, Seksioni 6 (viii) duhet të kryhet deri më 31.12.2026.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Informimi dhe raportet</p> <p>1. Autoriteti shëndetësor duhet të publikojë një raport vjetor për cilësinë e ujit të pijshëm për konsum njerëzor të furnizuar nga furnizuesit e ujit në Kosovë në mënyrë që t'i informojë konsumatorët, duke përdorur rezultatet nga programi i monitorimit të përputhshmërisë.</p> <p>2. Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'i përmbledh rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit, përfshirë rezultatet e mospërputhshmërisë për vitin aktual dhe përfshin të gjithë parametrat relevant të listuar në Shtojcën 1 Pjesa A, Pjesa B, dhe Pjesa C dhe identifikon çdo trend të përkeqësimit të standardeve të cilësisë së ujit të pijshëm veçanërisht sa i përket mospërputhshmërisë me vlerat mikrobiologjike të Pjesës A dhe masat e rekomanduara nga furnizuesit e ujit për të adresuar trendet dhe detajet e çdo sanksioni të aplikuar për furnizuesit e ujit nga Inspektorati Sanitar pas mospërputhshmërisë.</p> <p>3. Raporti vjetor publikohet në faqen e internetit të Institutit Kombëtar të</p>	<p>requirements of Annex 2 Part C section 6(viii) shall be completed by 31.12.2026.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Information and reports</p> <p>1.The Health Authority shall publish an annual report on the drinking water quality for human consumption supplied by water suppliers in Kosovo in order to inform consumers, using the results from the compliance monitoring programme.</p> <p>2.The report under paragraph 1 of this Article shall summarise the results of monitoring of water quality including non-compliance results for the current year and include all the relevant parameters listed in Annex 1 Part A, Part B, and Part C and identify any trends in deterioration of drinking water quality standards especially regarding non-compliances with Part A microbiological values and the recommended measures by the water suppliers to address the trends and details of any sanctions applied to the water supplier by the Sanitary Inspectorate following the non-compliance.</p> <p>3.The annual report shall be publicly available on the web site of the National Institute of</p>	<p>završi do 31.12.2026. godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Informisanje i izveštaji</p> <p>1.Zdravstveni organ treba da objavi jedan godišnji izveštaj o kvalitetu pijaće vode za ljudsku upotrebu kojom snabdevaju snabdevači vodom na Kosovu, kako bi informisao potrošače, koristeći rezultate iz programa praćena usaglašenosti.</p> <p>2.Izveštaj iz stava 1 ovog člana treba da sadrži rezultate praćenja kvaliteta vode, obuhvatajući i rezultate neusaglašenosti za trenutnu godinu i obuhvata sve relevantne parametre navedene u Dodatku 1, delovima A, B i C i identifikuje svaki trend pogoršanja standarda kvaliteta pijaće vode, posebno što se tiče neusaglašenosti sa mikrobiološkim vrednostima dela A i preporučene mere od strane snabdevača vodom, kako bi tretirao trendove i detalje svake primenjene sankcije za snabdevače vodom od strane Sanitarne inspekcije nakon neusaglašenosti.</p> <p>3.Godišnji izveštaj se objavljuje na internet stranici Nacionalnog instituta za javno</p>
--	---	--

<p>Shëndetësisë Publike.</p> <p>4. Një raport i veçantë përmbledhës që mbulon secilën periudhë trevjeçare duhet të publikohet nga Autoriteti shëndetësor brenda një viti pas kalimit të tri (3) viteve të mbuluara dhe do t'i dërgohet Komisionit Evropian brenda dy muajve nga publikimi.</p> <p>5. Raporti i referuar në paragrafin 4 të këtij neni duhet së paku të përfshijë të gjitha furnizimet e veçanta të furnizimit me ujë që tejkalojnë kapacitetin mesatar prej 1000 m³ në ditë apo që i shërbejnë më shumë se 5000 personave, dhe ai raport duhet të mbulojë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh kalendarik dhe të publikohet brenda gjashtë muajsh nga përfundimi i periudhës raportuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Shtojcat</p> <p>1.Shtojca e bashkangjitur këtij udhëzimi administrativ do të jenë pjesë e tij:</p> <p>1.1 Shtojca 1: Parametrat dhe vlerat parametrike;</p> <p>1.2 Shtojca 2: Monitorimi;</p> <p>1.3 Shtojca 3: Specifikimet për analizën e parametrave;</p>	<p>Public Health.</p> <p>4.A separate summary report covering each three (3) year period shall be published by the Health Authority within a year after three covered years and sent to the European Commission within two months from the publication.</p> <p>5. The report referred to in paragraph 4 of this Administrative Instruction should at least include all individual supplies of water that exceed the capacity of 1000 m³ a day as an average or serving more than 5000 people, and it must cover a period of twelve (12) calendar months and be published within six (6) months from the end of the reporting period.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Annexes</p> <p>1.The annexes attached to this Administrative Instruction shall be parts thereof:</p> <p>1.1 Annex 1: Parameters and parametric values;</p> <p>1.2 Annex 2: Monitoring;</p> <p>1.3 Annex 3: Specidications for analysis of parameters;</p>	<p>zdravlje.</p> <p>4.Poseban sažet izveštaj koji pokriva svaki trogodišnji period treba da objavi zdravstveni organ u roku od godinu dana nakon isticanja tri (3) pokrivenih godine i da se pošalje Evropskoj komisiji u roku od dva meseca od objavljivanja.</p> <p>5.Izveštaj iz člana 4 ovog člana, treba makar da sadrži sva pojedinačna snabdevanja vodom koja prevazilaze prosečni kapacitet od 1000 m³ dnevno ili koji uslužuju više od 5000 lica, i on treba da pokrije period od dvanaest (12) kalendarskih meseci i da se objavi u roku od šest (6) meseci od završetka perioda izveštavanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Dodaci</p> <p>1.Dodaci priloženi ovom Administrativnom uputstvu biće njegovi sastavni delovi</p> <p>1.1 Dodatak 1: Parametri i parametarske vrednosti;</p> <p>1.2 Dodatak 2: Praćenje;</p> <p>1.3 Dodatak 3: Specifikacije o analizi parametara;</p>
---	--	--

<p>1.4 Shtojca 4: Monitorimi i substancave radioaktive;</p> <p>1.5 Shtojca 5: Monitorimi për dozën indikative dhe karakteristikat e sistemeve analitike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 16/2012 për Cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë ditë (7) pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Albin Kurti</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: center;">13.dhjetor.2021</p>	<p>1.4 Annex 4: Monitoring of radioactive substances;</p> <p>1.5 Annex 5: Monitoring for Indicative Dose and analytical systems characteristics.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Abrogation</p> <p>1. When this Administrative Instruction enters into force, the Administrative Instruction 16/2012 on the Quality of water intended for human consumption is repealed.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Entry into Force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Albin Kurti</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Prime Minister of the Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">13.December.2021</p>	<p>1.4 Dodatak 4: Praćenje radioaktivnih supstanci;</p> <p>1.5 Dodatak 5: Praćenje indikativne doze i karakteristike analitičkih sistema.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Stavljanje van snage</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva, stavlja se van snage Administrativno uputstvo br. 16/2012 o kvalitetu vode za ljudsku potrošnju.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavlivanja u Sluzbenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Albin Kurti</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Premijer Republike Kosovo</p> <p style="text-align: center;">13.decembar.2021</p>
---	---	--

Shtojca 1

Parametrat dhe Vlerat Parametrike

PJESA A: Parametrat mikrobiologjikë

Tabela 1: Parametrat mikrobiologjikë

Parametri	Vlera parametrike (numri /100 ml)
<i>Escherichia coli (E. coli)</i>	0
Enterokoket	0

Pjesa e dhënë më poshtë do të aplikohet për ujin e ofruar në shishe dhe kontejner (ujin e ambalazhuar):

Tabela 2: Parametrat mikrobiologjikë për ujin e ofruar në shishe dhe kontejner

Parametri	Vlera parametrike
<i>Escherichia coli (E. coli)</i>	0/250 ml
Enterokoket	0/250 ml
<i>Pseudomonas aeruginosa</i>	0/250 ml
Kolonia e llogaritur në 22 °C	100/ml
Kolonia e llogaritur në 37 °C	20/ml

**PJESA B:
Parametrat kimikë**

Tabela 3: Parametrat kimikë

Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënim
Akrilamide	0,10	µg/l	Shënimi 1
Antinomi	5,0	µg/l	
Arseni	10	µg/l	
Benzeni	1,0	µg/l	
Benzo(a)pyrene	0,01	µg/l	
Bori	1,0	mg/l	
Bromatet	10	µg/l	Shënimi 2
Kadmiumi	5,0	µg/l	
Kromi	50	µg/l	
Bakri	2,0	mg/l	Shënimi 3
Cianidi	50	µg/l	
1,2 - dikloroetani	3,0	µg/l	
Epiklorohidrini	0,10	µg/l	Shënimi 1
Fluori	1,5	mg/l	
Plumbi	10	µg/l	Shënimi 3 dhe 4
Merkuri	1,0	µg/l	

Nikeli	20	µg/l	Shënimi 3
Nitratet	50	mg/l	Shënimi 5
Nitritet	0,50	mg/l	Shënimi 5
Pesticidet	0,10	µg/l	Shënimi 6 dhe 7
Pesticidet totale	0,50	µg/l	Shënimi 6 dhe 8
Hidrokarburet aromatike policiklike (PAH)	0,10	µg/l	Sasia e përqendrimit specifik të përbërësve Shënimi 9
Seleni	10	µg/l	
Tetrakloreteni dhe trikloreteni	10	µg/l	Sasia e përqendrimit specifik të parametrave
Trihalometanet (THM) total	100	µg/l	Sasia e përqendrimit specifik të përbërësve Shënimi 10
Vinil kloridi	0,50	µg/l	Shënimi 1
Kloritet	0,7	mg/l	Shënimi 2a
Mbetja e klorit	0,2	mg/l	Shënimi 2b

Shënimi 1: Vlera parametrike i referohet përqendrimit të monomerit rezidual në ujë të llogaritur sipas specifikimeve të lirit maksimal nga polimeri korrespondues në kontakt me ujin.

Shënimi 2: Aty ku është e mundur, furnizuesit e ujit duhet të synojnë vlera më të ulëta, pa e dëmtuar dezinfektimin. Për ujin e përmendur në nenin 5 (1) (1.1), (1.2) dhe (1.4), vlera duhet të arrihet jo më vonë se 10 vjet kalendarik nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi. Vlera e parametrave për bromin midis pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe 10 vjet pas hyrjes në fuqi të tij është 25 µg / l.

Shënimi 2a: Zbatohet kur dioksidi i klorit përdoret për qëllime të dezinfektimit. Ku është e mundur, furnizuesit e ujit duhet të synojnë vlera më të ulëta pa e dëmtuar dezinfektimin.

Shënimi 2b: Vlera minimale e rekomanduar e pranueshme në sistemin e shpërndarjes ose në pikën e konsumit ku klori përdoret për dezinfektim.

Shënimi 3: Vlera e aplikuar në mostrën e ujit të destinuar për të u përdorur për konsum njerëzor e marrë përmes metodës përkatëse të mostrimit në rubinet dhe e marrë në atë mënyrë që të përfaqësojë sasinë mesatare javore të ujit që pihet nga konsumatorët. Kur është e nevojshme, metodat e mostrimit duhet të zbatohen bazuar në dokumentet udhëzuese të nxjerra nga Komisioni Evropian. Autoriteti shëndetësor duhet të marrë parasysh paraqitjen e nivelit të pikut që mund të shkaktojë efekte të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Shënim 4: Për ujin e referuar në Nenin 5(1)(1.1), (1.2) dhe (1.4), vlera duhet të përmbushet, së paku pesë vite kalendarike pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ të referuar në nenin 14.

Vlera parametrike për plumbin në periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ deri në 5 vite pas hyrjes në fuqi është 25 µg/l.

Autoriteti shëndetësor dhe furnizuesit e ujit duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të zvogëluar përqendrimin e plumbit në ujë të destinuar që të përdoret për konsum njerëzor, sa më shumë që të jetë e mundur gjatë periudhës së nevojshme për të arritur përputhshmërinë për vlerën parametrike. Gjatë zbatimit të masave për arritjen e pështatshmërisë duhet t'u jepet prioritet atyre masave në Kosovë ku niveli i përqendrimit të plumbit në ujin që synohet të përdoret për konsum njerëzor është më i lartë.

Shënim 5: Duhet të sigurohen kushtet që $\{[\text{nitrat}] / 50 + [\text{nitrit}] / 3 \leq 1\}$, kllapat tregojnë se është arritur përqendrimi në mg/l për nitrate (NO₃) dhe nitrite (NO₂) dhe se vlera prej 0.10 mg/l për nitrite është arritur pas daljes së ujit nga impiantet e trajtimit të ujit.

Shënimi 6: 'Pesticidet' përfshijnë:

- Insekticidet organike,
- Herbicidet organike,
- Fungicidet organike,
- Nematocidet organike,
- Akaricidet organike,
- Algecidet organike,
- Rodenticidet organike,
- Slimicidet organike,
- Produkte e ngjashme (ndër tjera, rregulluesit e rritjes)dhe metabolidet e tyre relevante, produktet e degradimeve dhe të reaksioneve të tyre.

Duhet të monitorohen vetëm pesticidet që mund të jenë të pranishme në një zonë të caktuar të furnizimit.

Shënimi 7:Vlera parametrike vlen për secilin pesticid individual. Në rast të aldrinit, dieldrinit, hepatoklorexpocidit vlera parametrike është 0.030 µg/l.

Shënimi 8: 'Pesticidet totale' nënkupton sasinë e të gjitha pesticideve individuale të zbuluara dhe të kuantifikuara në procedurën e monitorimit.

Shënimi 9: Përbërësit specifikë:

-benzo(b)fluranteni,

-benzo(k)fluranteni,

-benzo(ghi)perylene,

-indeno(1,2,3-cd)pyrini.

Shënimi 10: Ku është e mundur, furnizuesit e ujit duhet të synojnë në vlera më të ulëta pa e rrezikuar dezinfektimin. Përbërjet specifike janë: koliformi, bromoformi, dibromoklorometani, bromodiklorometani.

Për ujin e referuar në Nenin 5(1)(1.1), (1.2) dhe (1.4), vlera duhet të përmbushet, së paku pesë vite kalendrike pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ të referuar në nenin 14. Vlera parametrike për të gjitha trihalometanet (THM), në periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ deri në 5 vite pas hyrjes në fuqi është 150 µg/l.

Duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të ulur përqendrimin e THM-së në ujë të destinuar për konsum njerëzor sa më shumë që të jetë e mundur gjatë periudhës së nevojshme për të arritur përputhshmërinë me vlerën parametrike. Kur zbatohen masat për të arritur këtë vlerë, prioritet duhet tu jepet në mënyrë progresive atyre zonave ku përqendrimet e THM-së në ujë të destinuar për konsum të njeriut janë më të larta.

PJESA C: Parametrat indikatorë

Tabela 4: Parametrat indikatorë

Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime
Alumini	200	µg/l	
Amoniumi	0,50	mg/l	
Kloruret	250	mg/l	Shënimi 1

Clostridium perfringens (përfshirë sporet)	0	numri/100 ml	Shënimi 2
Ngjyra	E pranueshme për konsumatorët pa ndonjë ndryshim abnormal		
Përçueshmëria	2500	μS cm - 1 në 20°C	Shënimi 1
Përqendrimi i jonit dhe hidrogjenit	≥ 6,5 dhe ≤ 9,5	Njësitë pH	Shënimi 1 dhe 3
Hekuri	200	μg/l	
Mangani	50	μg/l	
Era	E pranueshme për konsumatorët, pa ndonjë ndryshim abnormal		
Harxhimi i O ₂ (Oksiditeti)	5,0	mg/l O ₂	Shënimi 4
Sulfati	250	mg/l	Shënimi 1
Natriumi	200	mg/l	
Shija	E pranueshme për konsumatorët, pa ndonjë ndryshim abnormal		
Vlerësimi i llogaritjes së	Pa ndryshime		

kolonisë 22 °	abnormale		
Bakteriet koliforme	0	numri/100 ml	Shënimi 5
Karboni organik total (TOC)	Pa ndryshime abnormale		Shënimi 6
Turbullira	E pranueshme për konsumatorët pa ndonjë ndryshim abnormal		Shënimi 7

Shënimi 1: Uji nuk duhet të jetë agresiv.

Shënimi 2: Ky parametër nuk duhet të matet përveç nëse uji është me origjinë ose ndikohet nga uji sipërfaqësor. Në rast të mospërputhshmërisë me këtë vlerë parametrike, Autoriteti shëndetësor duhet të hulumtojë furnizimin dhe duhet të sigurojë që mospërputhshmëria nuk përbën rrezik për shëndetin e njeriut që do të vinte si rezultat i pranisë së mikroorganizmave patogjenë, p.sh. cryptosporidium. Autoriteti shëndetësor duhet të përfshijë rezultatet e të gjitha hulumtimeve të tilla në raportet që duhet t'i dorëzojë në bazë të nenit 16, paragrafi 1.

Shënimi 3: Për ujin e thjeshtë të vendosur në shishe apo kontejnerë, vlera minimale mund të zvogëlohet në 4.5 njësi të pH. Për ujin e vendosur në shishe apo kontejnerë i cili është pasuruar në mënyrë natyrale apo artificiale me dioksid karboni, vlera minimale mund të jetë më e ulët.

Shënimi 4: Ky parametër nuk ka nevojë të matet nëse është analizuar parametri TOC.

Shënimi 5: Për ujin e vendosur në shishe apo kontejner njësia është numër/250 ml.

Shënimi 6: Ky parametër nuk ka nevojë të matet për ujësjellësit që furnizojnë më pak se 10,000 m³ në ditë.

Shënimi 7: Në rast të trajtimit të ujërave sipërfaqësore, vlerat parametrike nuk duhet t'i kalojnë 1.0 NTU (njësi nefelometrike të turbullirës) në ujë pas daljes nga fabrika e trajtimit.

PJESA D: Parametrat radioaktivë

Tabela 5: Parametrat radioaktivë

Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime
Radoni	100	Bq / l	Shënimi 1
Tritiumi	100	Bq / l	Shënimi 2
Doza totale indikative	0,10	mSv/vit	

Shënimi 1: Autoriteti shëndetësor mund të caktojë një nivel për radonin i cili gjykohet se nuk është mirë të tejkalohe dhe nën të cilin duhet të vazhdojë optimizimi i mbrojtjes, pa dëmtuar furnizimin me ujë në shkallë shtetërore ose rajonale. Niveli i vendosur nga Autoriteti shëndetësor mund të jetë më i lartë se 100 Bq/l, por më i ulët se 1000 Bq/l. Në mënyrë që të thjeshtësohet legjislacioni, Autoriteti shëndetësor mund të zgjedhë të rregullojë vlerën parametrike në këtë nivel.

Veprimi korigjues konsiderohet se është i justifikuar në baza të mbrojtjes radiologjike pa konsideratë të mëtejshme kur përqendrimet e radonit tejkalojnë 1000Bq/l

Shënimi 2: Nivelet e ngritura të tritiumit mund të tregojnë prani të radionuklideve të tjera artificiale. Nëse përqendrimi i tritiumit tejkalon vlerën e tij parametrike, duhet të kërkohet një analizë e pranisë së radionuklideve të tjera artificiale.

Shtojca 2

MONITORIMI

PJESA A:

Objektivat e përgjithshëm dhe programet e monitorimit për ujin e destinuar për konsum njerëzor

1. Programet e monitorimit për ujin e destinuar për konsum njerëzor duhet:

a) të verifikojnë nëse masat e përcaktuara për kontrollin e rreziqeve për shëndetin e njeriut përgjatë tërë zinxhirit të furnizimit me ujë të pijshëm janë duke funksionuar në mënyrë efektive dhe se uji në pikën e përputhshmërisë është i shëndetshëm dhe i pastër. Për qëllimin e kësaj Shtojce, zinxhiri i furnizimit me ujë të pijshëm përfshin të gjitha fazat dhe operacionet e përfshira në ujëmbledhës, marrje, prodhim, trajtim, shpërndarje, rezervimin dhe menaxhim të ujit të destinuar për konsum njerëzor, në të gjitha aspektet e ndërlidhura, përfshirë këtu në lidhje me mjedisin që rrethon zonën ujëmbledhëse, materialet dhe proceset;

b) të japin informacione mbi cilësinë e ujit të furnizuar për konsum njerëzor për të demonstruar se janë duke u përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 4 dhe vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën I;

c) të identifikojnë mjetet më të përshtatshme për zbutjen e rrezikut për shëndetin e njeriut. Në bazë të nenit 6, do të zhvillohen programe të monitorimit që përputhen me parametrat dhe frekuencat e përcaktuara në Pjesën B të kësaj Shtojce të cilat përbëhen nga:

a) mbledhja dhe analiza e mostrave diskrete të ujit; dhe/ose

b) matjet e regjistruara në një proces të monitorimit të vazhdueshëm.

3. Programet e monitorimit kërkojnë që monitorimi të bëhet në tërë zinxhirin e furnizimit me ujë të pijshëm, sipas specifikimeve të nenit 6.

4. Programet e monitorimit mund të përfshijnë:

a) inspektimet e të dhënave të funksionalitetit dhe statusin e mirëmbajtjes së pajisjeve; dhe/ose

b) inspektimet e zonës ujëmbledhëse dhe infrastrukturës së ujëmbledhësit, trajtimit, rezervimit dhe shpërndarjes.

5. Programet e monitorimit mund të bazohen në një vlerësim të rrezikut siç përcaktohet në Pjesën C të kësaj Shtojce, në bazë të vlerësimit të furnizuesit të ujit.

6. Programet e monitorimit mund të bazohen në rezultatet e të dhënave të plota, referuar së paku (tri) 3 viteve të fundit të rezultateve të monitorimit të rregullt në bazë të nenit 7 dhe 8.

7. Programet e monitorimit duhet të rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditësohen ose rikonfirmohen të paktën çdo pesë vjet.

PJESA B: Parametrat dhe frekuencat

1.Korniza e përgjithshme

Programi i monitorimit duhet të marrë parasysh parametrat e cekura në Shtojcën I, përfshirë ata që janë të rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit të sistemeve të shpërndarjes shtëpiake në cilësinë e ujit në pikën e përputhshmërisë, siç përcaktohet në nenin 5, parag. 1. Kur zgjidhen parametrat e duhur për monitorim, duhet të merren në konsideratë kushtet lokale për secilin sistem të furnizimit me ujë të pijshëm dhe monitorimi operacional i kërkuar nga furnizuesi i ujit për të verifikuar cilësinë e ujit për konsum njerëzor, siç përmendet në nenin 7, i cili duhet të bazohet në vlerësimin e rrezikut nga furnizuesi i ujit, siç përcaktohet në Pjesën C.

Parametrat e shënuar në pikën 2 më poshtë duhet të monitorohen nga Autoriteti shëndetësor në përputhje me frekuencat e mostrimit të përcaktuara në pikën 3.

2.Lista e parametrave

Parametrat e Grupit A

Parametrat e mëposhtëm (Grupi A) monitorohen në përputhje me frekuencat e monitorimit të përcaktuara në Tabelën 6 të pikës 3:

- a)Escherichia coli (E. coli), bakteret koliforme, llogaritja e kolonisë 22 °C, ngjyra e klorit rezidual, turbullira, shija, aroma, pH, përçueshmëria;
- b)parametrat e tjerë të identifikuar si të rëndësishëm në programin e monitorimit, në pajtim me obligimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 dhe, kur është e rëndësishme, përmes vlerësimin të rrezikut, siç përcaktohet në Pjesën C.

Në rrethana specifike, parametrave të Grupit A do tu shtohen edhe këta parametra:

- a)Amoniaku dhe nitritet nëse përdoret kloraminimi;
- b)Aluminiumi dhe hekuri nëse përdoren si kimikate për trajtimin e ujit.

Parametrat e Grupit B

Për të përcaktuar përputhshmërinë me të gjitha vlerat parametrike të paraqitura në Shtojcën I, të gjithë parametrat e tjerë që nuk janë analizuar nën Grupin A dhe të përcaktuar në Shtojcën I, do të monitorohen të paktën në frekuencat e paraqitura në Tabelën 5, shtylla e tretë.

3.Frekuencat e mostrimit

Tabela 6: Frekuenca minimale e mostrimit dhe analizës për monitorimin e përputhshmërisë

Vëllimi i ujit të shpërndarë ose prodhuar çdo ditë në një zonë të furnizimit (Shih Shënimin 1 dhe 2)		Parametri i grupit A numri i mostrave në vit (shih Shënimin 3)	Parametri i grupit B numri i mostrave në vit
	≤100	>0 (shih Shënimin 4)	>0 (shih Shënimin 4)
>100	≤1 000	4	1
>1 000	≤10 000	4 + 3 për çdo 1 000 m ³ /d dhe një pjesë të vëllimit të përgjithshëm	1 + 1 për çdo 4 500 m ³ /d dhe një pjesë të vëllimit të përgjithshëm
>10 000	≤100 000		3 + 1 për çdo 10 000 m ³ /d dhe një pjesë të vëllimit të përgjithshëm
>100 000			12 + 1 për çdo 25 000 m ³ /d dhe një pjesë të vëllimit të përgjithshëm

Shënim :1 Zona e furnizimit me ujë është zona e definuar gjeografike brenda të cilës uji i destinuar për konsum njerëzor vjen nga një apo n shumë burime dhe cilësia e ujit mund të konsiderohet se është përfaqësues e njëjtë.

Shënim:2 Vëllimet llogariten si mesatare të marra gjatë një viti kalendarik. Në vend të vëllimit të ujit mund të përdoret numri i banorëve i një zonë të furnizimit për të përcaktuar frekuencën minimale, duke supozuar konsumin e ujit prej 200 l/ditë për kokë banori.

Shënim:3 Frekuenca e treguar llogaritet si më poshtë: p.sh. $4\ 300\ m^3/d = 16$ mostra (katër për $1\ 000\ m^3/d$ të para + 12 për $3\ 300\ m^3/d$ të tjera

Shënim:4 Frekuenca duhet të përcaktohet nga autoriteti shëndetësor lokal.

PJESA C

Vlerësimi i rrezikut

1. Është e mundur të derogohet nga parametrat dhe frekuencat e mostrimit në Pjesën B, me kusht që të bëhet një vlerësim i rrezikut në përputhje me këtë Pjesë.

2. Vlerësimi i rrezikut i përmendur në pikën 1 më lart, bëhet nga furnizuesi i ujit edhe për të identifikuar kërkesat e monitorimit operacional siç përmenden në nenin 7. Vlerësimi i rrezikut bazohet në parimet e përgjithshme të vlerësimit të rrezikut të përcaktuara në lidhje me standardet ndërkombëtare, siç është standardi EN 15975-2 (Siguria e furnizimit të ujit të pijshëm - Udhëzimet për menaxhimin e rrezikut dhe krizave) dhe/ose Udhëzimet Kombëtare për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut në zinxhirin e furnizimit të ujit të destinuar për konsum njerëzor bazuar në modelin e Planit të Sigurisë së Ujit.

3. Vlerësimi i rrezikut duhet të marrë parasysh rezultatet e Programit të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të Republikës së Kosovës të kryer në pajtim me legjislacionin në fuqi, veçanërisht sa i përket programeve të monitorimit të përcaktuara për ujërat që përdoren për marrjen e ujit të pijshëm, si dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me burimet ujore për konsum njerëzor, përfshirë, ndër të tjera, ato që lidhen me zonat mbrojtëse të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor për konsum njerëzor, shqyrtimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor dhe informatat mbi presionet e konsiderueshme dhe zonat e rrezikuara nga ndotja me nitrate dhe pesticide nga bujqësia dhe produktet për mbrojtjen e bimëve.

4. Vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë:

a) bazën e të dhënave për zinxhirin e furnizimit të ujit të pijshëm, vlerësimin e rrezikut dhe masat e kontrollit dhe monitorimit,

b) ripërcaktimin e 'zonave të furnizimit me ujë të pijshëm' bazuar në përshkrimin e zinxhirit të furnizimit me ujë të pijshëm;

c) monitorimin e të dhënave për elementet kimike dhe substancat që zakonisht nuk janë subjekt i monitorimit në bazë të faktorëve të rrezikut specifik për një lokacion, kur është e nevojshme;

5. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut zgjerohet lista e parametrave në pikën 2 të Pjesës B më poshtë dhe/ose rritet frekuenca e mostrimit në pikën 3 të pjesës B, kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) lista e parametrave ose frekuencave të parapara në këtë Shtojcë nuk është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 6, paragrafët 1, 2 dhe 3;

b) kërkohet monitorim shtesë për qëllime të nenit 8, paragrafit 3;

c) është e nevojshme të ofrohen garancitë e nevojshme të përcaktuara në pikën (1)(a) të Pjesës A.

6. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut, lista e parametrave të përcaktuar në pikën 2 të Pjesës B dhe frekuencat e mostrimit të përcaktuara në pikën 3 të Pjesës B mund të zvogëlohen nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) frekuenca e mostrimit për *E. coli* në asnjë rrethanë nuk duhet të ulet nën atë të përcaktuar në pikën 3 të Pjesës B;

b) për të gjithë parametrat e tjerë:

1. lokacioni dhe frekuenca e mostrimit përcaktohet në lidhje me origjinën e parametratit, si dhe ndryshueshmërinë dhe trendin afatgjatë të përqendrimit të tij, duke marrë parasysh nenin 5;

2. për të zvogëluar frekuencën minimale të mostrimit të parametratit, siç përcaktohet në pikën 3 të Pjesës B, të gjitha rezultatet e fituara nga mostrat e mbledhura në intervale të rregullta përgjatë një periudhe prej së paku tri vitesh nga pikat e mostrimit që përfaqësojnë tërë zonën e furnizimit duhet të jenë më pak se 60% e vlerës parametrike.

3. për të hequr një parametër nga lista e parametrave që do të monitorohen, siç përcaktohet në pikën 2 të Pjesës B, të gjitha rezultatet e fituara nga mostrat e mbledhura në intervale të rregullta përgjatë një periudhe prej së paku tri vitesh nga pikat e mostrimit që përfaqësojnë tërë zonën e furnizimit duhet të jenë më pak se 30% e vlerës parametrike.

4. heqja e një parametri të veçantë të paraparë në pikën 2 të Pjesës B nga lista e parametrave që monitorohen duhet të bazohet në rezultatin e vlerësimit të rrezikut, duke u informuar nga rezultatet e monitorimit të burimeve të ujit të destinuar për konsum njerëzor dhe duke konfirmuar se shëndeti i njeriut është i mbrojtur nga efektet e dëmshme të ndonjë ndotjeje të ujit të destinuar për konsum njerëzor, siç përcaktohet në nenin 1;

5. frekuenca e mostrimit mund të zvogëlohet ose një parametër mund të hiqet nga lista e parametrave që monitorohen siç përcaktohet në pikat (ii) dhe (iii) vetëm nëse vlerësimi i rrezikut konfirmon se asnjë faktor, për aq sa mund të parashihet në mënyrë të arsyeshme, nuk ka gjasa të shkaktojë përkeqësim të cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor.

6. të gjitha aprovimet e vlerësimit të rrezikut, bashkë me një përmbledhje të rezultateve, duhet të vihen në dispozicion të publikut.

PJESA D

Metodat e mostrimit dhe pikat e mostrimit

1. Pikat e mostrimit përcaktohen ashtu që të sigurojnë pajtueshmërinë me pikat e përputhshmërisë të parapara në nenin 5, paragrafi 1. Në rastin e një rrjeti të shpërndarjes, mostrat mund të merren brenda zonës së furnizimit ose gjatë punëve së trajtimit për parametra të veçantë nëse mund të demonstron se nuk do të ketë ndonjë ndryshim negativ në vlerën e matur të parametrave në fjalë. Për aq sa është e mundur, numri i mostrave do të shpërndahet në mënyrë të barabartë në kohë dhe lokacione.

2. Mostrimi në pikën e përputhshmërisë duhet të plotësojë këto kushte:

a) mostrat e përputhshmërisë për parametra të caktuar kimikë (në veçanti për bakër, plumb dhe nikel) do të merren në rubinetin e konsumatorit pa e lëshuar ujin të rrjedhë paraprakisht. Duhet të merret një mostër e rastësishme gjatë ditës në vëllim prej një litre. Si alternativë, mund të përdoren metodat e kohës fikse të stagnimit që reflektojnë më mirë gjendjen në nivel vendi, me kusht që në nivel të zonës së furnizimit kjo të mos rezultojë me më pak raste mospërputhjes sesa kur përdoret metoda e rastësishme gjatë ditës;

b) mostrat e përputhshmërisë për parametrat mikrobiologjikë në pikën e përputhshmërisë do të merren sipas standardit EN ISO 19458 (qëllimi i mostrimit B).

3. Mostrimi në rrjetin e shpërndarjes, me përjashtim të mostrimit në rubinetin e konsumatorëve, duhet të jetë në përputhje me standardin ISO 5667-5. Për parametrat mikrobiologjikë, mostrat në rrjetin e shpërndarjes duhet të merren dhe trajtohen sipas standardit EN ISO 19458 (qëllimi i mostrimit A).

Shtojca 3

SPECIFIKIMET PËR ANALIZËN E PARAMETRAVE

1. Laboratorët, ose palët e treta që marrin kontrata laboratorike, duhet të aplikojnë praktikat e menaxhimit të cilësisë në pajtim me standardin EN ISO/IEC 17025 ose me standardet e tjera ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht dhe duhet të akreditohen, në pajtim me standardin UNI EN ISO/IEC 17025: 2017 që përcakton 'Kushtet e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues', nga një subjekt i përcaktuar akreditues, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 765/2008. Akreditimi dhe vlerësimi i laboratorëve testues kanë të bëjnë me teste individuale ose grupe testesh dhe duhet të përfundojnë deri më 31 dhjetor 2021.

2. Metodot e analizave të përdorura për qëllime të monitorimit dhe për të demonstruar pajtueshmërinë me këtë udhëzim administrativ do të vërtetohen dhe dokumentohen në përputhje me standardin EN ISO/IEC-17025 ose me standarde të tjera ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht. Në mungesë të një metode të analizës që plotëson kriteret minimale të performancës të parapara në Pjesën B, monitorimi do të bëhet duke aplikuar teknikat më të mira në dispozicion që nuk shkaktojnë shpenzime të tepërta.

PJESA A

Parametrat mikrobiologjikë për të cilët janë specifikuar metodat e analizës

Metodat për parametrat mikrobiologjikë janë:

- Escherichia coli (E. coli) dhe bakteret koliforme (EN ISO 9308-1 ose EN ISO 9308-2);
- Enterokoket (EN ISO 7899-2);
- Pseudomonas aeruginosa (EN ISO 16266);
- numërimi i mikroorganizmave të kultivueshëm - llogaritja e kolonisë 22° C (EN ISO 6222);
- numërimi i mikroorganizmave të kultivueshëm - llogaritja e kolonisë 36° C (EN ISO 6222);
- Clostridium perfringens përfshirë sporet (EN ISO 14189)

PJESA B

Parametrat kimikë dhe tregues për të cilët janë specifikuar karakteristikat e performancës

1.Parametrat kimikë dhe indikatorë

Për parametrat e paraparë në Tabelën 7, karakteristikat e specifikuara të performancës janë që metoda e analizës që përdoret duhet, si minimum, të jetë në gjendje të matë përqendrimit e barabarta me vlerën parametrike me një kufi të kuantifikimit prej 30% ose më pak të vlerës përkatëse parametrike dhe një pasiguri e matjes, siç përcaktohet në Tabelën 7. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, 'kufiri i kuantifikimit' nënkupton një shumëfish të deklaruar të 'kufirit të detektimit' në një përqendrim të përbërësit që mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme me një nivel të pranueshëm të saktësisë dhe përpikërisë. 'Kufiri i kuantifikimit' mund të llogaritet duke përdorur një standard ose mostër të përshtatshme, dhe mund të merret nga pika më e ulët e kalibrimit në kurbën e kalibrimit, duke përjashtuar pjesën e zbrazët.

Rezultati analitik shprehet duke përdorur së paku të njëjtin numër të shifrave të rëndësishme si për vlerën parametrike të konsideruar në Pjesët B dhe C të Shtojcës I.

Deri me 31 dhjetor 2021, përdorimi i 'vërtetësisë', 'saktësisë' dhe 'kufirit të detektimit', siç specifikohet në Tabelën 8, mund të përdoret si një grup alternativ i karakteristikave të performancës për 'kufirin e kuantifikimit' dhe 'pasigurinë e matjes' siç përcaktohet respektivisht në paragrafin e parë të kësaj pjese dhe në Tabelën 7.

Pasiguria e matjes e përcaktuar në Tabelën 7 nuk do të përdoret si tolerancë shtesë ndaj vlerave parametrike të përcaktuara në Shtojcën I.

Tabela 7: Karakteristika minimale e performancës 'Pasiguria e matjes'

Parametrat	Pasiguria e matjes (shih Shënimin 1)	Shënime
-------------------	---	----------------

	% e vlerës parametrike (përveç për pH)	
Alumini	25	
Amoniaku	40	
Antimoni	40	
Arseni	30	
Benzo(a)pireni	50	shih Shënimin 5
Benzeni	40	
Bori	25	
Bromatet	40	
Kadmiumi	25	
Kloruret	15	
Kromi	30	
Përçueshmëria	20	
Bakri	25	
Cianidi	30	shih Shënimin 6
1,2 - dikloretani	40	
Fluori	20	
pH e përqendrimit të joneve të hidrogjenit (i shprehur në njësi të pH)	0,2	shih Shënimin 7
Hekuri	30	
Plumbi	25	
Mangani	30	
Merkuri	30	
Nikeli	25	
Nitrati	15	
Nitriti	20	
Harxhimi i O ₂ (Oksiditeti)	50	shih Shënimin 8

Pesticidet	30	shih Shënimin 9
Hidrokarburet aromatike policiklike	50	shih Shënimin 10
Seleni	40	
Natriumi	15	
Sulfatet	15	
Tetrakloreteni	30	shih Shënimin 11
Trikloreteni	40	shih Shënimin 11
Trihalometanet - total	40	shih Shënimin 10
Karboni organik total (TOC)	30	shih Shënimin 12
Turbullira	30	shih Shënimin 13
Akrilamidi, epiklorhidrini dhe klorur vinili që kontrollohen nga specifikimet e produktit.		

Tabela 8: Karakteristikat minimale të performancës 'vërtetësia', 'saktësia' dhe 'kufiri i detektimit' - mund të përdoren deri më 31 Dhjetor 2021

Parametrat	Vërtetësia (shih Shënimin 2) % e vlerës parametrike (përveç për pH)	Preciziteti (shih Shënimin 3) % e vlerës parametrike (përveç për pH)	Limiti i detektimit (shih Shënimin 4) % e vlerës parametrike (përveç për pH)	Shënime
Aluminiumi	10	10	10	
Amoniaku	10	10	10	
Antimoni	25	25	25	
Arseni	10	10	10	
Benzo(a)pireni	25	25	25	
Benzeni	25	25	25	
Bori	10	10	10	

Bromati	25	25	25	
Kadmiumi	10	10	10	
Kloruret	10	10	10	
Kromiumi	10	10	10	
Përçueshmëria	10	10	10	
Bakri	10	10	10	
Cianidi	10	10	10	shih Shënimin 6
1,2 - dikloreteni	25	25	10	
Fluori	10	10	10	
pH e përqendrimit të joneve të hidrogjenit (i shprehur në njësi të pH)	0,2	0,2		shih Shënimin 7
Hekuri	10	10	10	
Plumbi	10	10	10	
Mangani	10	10	10	
Merkuri	20	10	20	
Nikeli	10	10	10	
Nitrati	10	10	10	
Nitriti	10	10	10	
Harxhimi i O ₂ (Oksiditeti)	25	25	10	shih Shënimin 8
Pesticidet	25	25	25	shih Shënimin 9
Hidrokarburet aromatike policiklike	25	25	25	shih Shënimin 10
Seleni	10	10	10	
Natriumi	10	10	10	
Sulfati	10	10	10	
Tetrakloreteni	25	25	10	shih Shënimin 11
Triklloreteni	25	25	10	shih Shënimin 11
Trihalomethanet - total	25	25	10	shih Shënimin 10

Turbullira	25	25	25	
Akrilamidi, epiklorhidrini dhe klorur vinili që kontrollohen nga specifikimet e produktit.				

Shënime për Tabelat 7 dhe 8:

Shënimi 1: Pasiguria e matjes është një parametër jo-negativ që e karakterizon shpërhapjen e vlerave të sasisë që i atribuohen një mase dhe bazuar në informacionin e përdorur. Kriteri i performancës për pasigurinë e matjes ($k = 2$) është përqindja e vlerës parametrike të deklaruar në tabelë ose vlerë më e mirë. Pasiguria e matjes vlerësohet në nivelin e vlerës parametrike, përveç nëse specifikohet ndryshe.

Shënimi 2: Vërtetësia është një masë e gabimit sistematik, d.m.th. diferenca në mes të vlerës mesatare të numrit të madh të matjeve të përsëritura dhe vlerës së vërtetë. Specifikimet e mëtejshme janë ato të përcaktuara në ISO 5725.

Shënimi 3: Përpikëria është një masë e gabimit të rastësishëm dhe zakonisht shprehet si devijim standard (brenda dhe ndërmjet serive) të përhapjes së rezultateve nga mesatarja. Përpikëria e pranueshme është dyfishi i devijimit relativ standard. Ky term është specifikuar më tej në ISO 5725.

Shënimi 4: Kufiri i detektimit është ose:

- tri herë devijimi standard brenda një serie të një mostre natyrore që përmban një përqendrim të ulët të parametrut, ose
- pesë herë devijimi standard i një mostre të zbrazët (brenda një serie).

Shënimi 5: Nëse vlera e pasigurisë së matjes nuk mund të përmbushet, duhet të zgjidhet teknika më e mirë në dispozicion (deri në 60%).

Shënimi 6: Metoda përcakton cianidin total në të gjitha format.

Shënimi 7: Vlerat për vërtetësinë, përpikërinë dhe pasigurinë e matjes shprehen në njësi të pH.

Shënimi 8: Metoda e referencës: EN ISO 8467

Shënimi 9:Karakteristikat e performancës për pesticide individuale janë dhënë si indikacion. Vlerat për pasigurinë e matjes për disa pesticide mund të jenë të ulëta deri në 30%, vlera më të larta deri në 80% mund të lejohen për një numër të pesticideve.

Shënimi 10:Karakteristikat e performancës aplikohen për substanca individuale, të specifikuar në 25% të vlerës parametrike në Pjesën B të Shtojcës I.

Shënimi 11:Karakteristikat e performancës aplikohen për substanca individuale, të specifikuar në 50 % të vlerës parametrike në Pjesën B të Shtojcës I.

Shënimi 12:Pasiguria e matjes duhet të vlerësohet në nivelin e 3 mg/l të karbonit organik total (TOC). Udhëzimet CEN 1484 do të përdoren në përcaktimin e TOC dhe karbonit organik të tretur (DOC).

Shënimi 13:Pasiguria e matjes duhet të vlerësohet në nivelin e 1.0 NTU (njësi turbiditeti nefelometrike) në pajtim me EN ISO 7027.

Shtojca 4

MONITORIMI I SUBSTANCAVE RADIOAKTIVE

1.Parimet e përgjithshme dhe frekuencat e monitorimit

Të gjithë parametrat për të cilët vlerat parametrike duhet të përcaktohen në pajtim me nenin 5, paragrafi 1, i nënshtrohen monitorimit. Sidoqoftë, nuk kërkohet asnjë monitorim i një parametri specifik kur një autoritet kompetent mund të përcaktojë se, për një periudhë kohore që do të përcaktohet prej tyre, ai parametër nuk ka të ngjarë të jetë i pranishëm në një furnizim të caktuar të ujit të destinuar për konsum njerëzor në përqendrime të cilat mund të tejkalojnë vlerën parametrike korresponduese.

Në rast të radionuklideve që ndodhin natyrshëm, kur rezultatet paraprake kanë treguar se përqendrimi i radionuklideve është stabil, frekuenca, në derogim nga kërkesat minimale të mostrimit të përcaktuara në pikën 6, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikun për shëndetin e njerëzve. Kur mbi bazën e analizave përfaqësuese, të dhënave të monitorimit ose informacioneve të tjera të besueshme që, për një periudhë kohe që do të përcaktohet prej tyre, gjykohet se nivelet të radonit, tritiumit ose të DI-së së llogaritur do mbeten nën vlerat përkatëse parametrike të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, nuk kërkohet të monitorohet uji i destinuar për konsum njerëzor ose të përcaktohet DI.

2.Radoni

Monitorimi siguron që janë bërë analiza përfaqësuese për të përcaktuar shkallën dhe natyrën e ekspozimeve të mundshme ndaj radonit në ujin e destinuar për konsum njerëzor që vjen nga lloje të ndryshme të burimeve ujore nëntokësore dhe puseve në zona të ndryshme gjeologjike. Ekzaminimet duhet të planifikohen në atë mënyrë që parametrat themelorë, dhe veçanërisht gjeologjia dhe hidrologjia e zonës, radioaktiviteti i shkëmbit ose dheut, dhe lloji i pusit, të mund të identifikohen dhe përdoren për të drejtuar veprimet e mëtejshme në zonat me ekspozim të mundshëm të lartë. Monitorimi i përqendrimeve të radonit bëhet kur ka arsye për të besuar, në bazë të rezultateve të analizave përfaqësuese ose informacioneve të tjera të besueshme, se mund të tejkalohet vlera parametrike e përcaktuar në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Tritiumi

Monitorimi i tritiumit në ujë të destinuar për konsum njerëzor bëhet kur një burim antropogjen i tritiumit ose i radionuklideve të tjera artificiale është i pranishëm brenda zonës ujëmbledhëse dhe në bazë të programeve të tjera të mbikëqyrjes ose hetimeve nuk mund të demonstrohet se niveli i tritiumit është nën vlerën parametrike të shënuar në këtë Udhëzim Administrativ. Kur kërkohet monitorimi për tritiumin ai do të bëhet në frekuencat e paraqitura në tabelën 9 më poshtë në këtë Shtojcë. Nëse përqendrimi i tritiumit tejkalon vlerën e tij parametrike, kërkohet një hetim i pranishëm të radionuklideve të tjera artificiale.

4. Doza indikative (DI)

Monitorimi i ujit të destinuar për konsum njerëzor për DI bëhet kur është i pranishëm një burim i radioaktivitetit artificial ose natyror i rritur dhe në bazë të programeve të tjera të mbikëqyrjes ose hetimeve nuk mund të tregohet se niveli i DI-së është nën vlerën parametrike të shënuar në këtë Udhëzim Administrativ. Kur kërkohet monitorimi për nivelet e radionuklideve artificiale, ai do të bëhet me frekuencën e paraqitur në tabelën 9. Kur kërkohet monitorim për nivelet radionuklidit natyror, frekuenca e monitorimit të aktivitetit bruto alfa, aktivitetit bruto beta ose radionuklideve natyrore individuale duhet të përcaktohet në varësi të strategjisë së ekzaminimit të miratuar prej tij. Frekuenca e monitorimit mund të ndryshojë prej një matjeje të vetme kontrolluese deri në frekuencat e paraqitura në tabelën 9. Kur është i nevojshëm vetëm një kontroll për radioaktivitetin natyror, do të kërkohet edhe një ri-kontroll së paku kur të ndodh ndonjë ndryshim lidhur me furnizimin i cili ka të ngjarë të ndikojë në përqendrime të radionuklideve në ujin e destinuar për konsum njerëzor.

5. Trajtimi i ujit

Kur të bëhet trajtimi për të ulur nivelin e radionuklideve në ujin e destinuar për konsum njerëzor, monitorimi do të bëhet në frekuencat e paraqitura në tabelën 9 për të siguruar efikasitetin e vazhdueshëm të këtij trajtimi.

6. Frekuencat minimale të mostrimit dhe analizave

Frekuencat minimale të mostrimit dhe analizave për monitorimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor të furnizuar nga rrjeti i shpërndarjes ose nga një cisternë që përdoret në një ndërmarrje e prodhimit të ushqimit duhet të jetë siç përcaktohet në tabelën në vijim:

Tabela 9: Frekuenca minimale e marrjes së mostrave dhe analizës për monitorimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor të furnizuar nga rrjeti i shpërndarjes ose nga një cisternë apo që përdoret në një ndërmarrje prodhuese ushqimore

Vëllimi i ujit të shpërndarë ose prodhuar çdo ditë brenda një zone të furnizimit, në m ³ (Shënimi 1 dhe 2)	Numri i mostrave në vit (Shënimi 3 dhe 4)
vëllimi ≤ 100	(Shënimi 5)
100 < vëllimi ≤ 1 000	1
